



AKTET E SIMPOZIUMIT SHKENCOR

“LLAZAR (ZAI) FUNDO- FIGURË E SHQUAR E MENDIMIT SHQIPTAR DHE EVROPIAN”

*(Përmbledhje materialesh përgatitur
nga Universiteti “Fan S. Noli”,
me mbështetjen e Këshillit të Qarkut të
Korçës)*

ISBN:

16 MAJ, 2025

BORDI SHKENCOR

Prof. dr. Lorenc EKONOMI, Rektor, Universiteti “Fan S. Noli”

Dr. Erjon NEXHIPI, Kryetar, Këshilli i Qarkut Korçë

Dr. Aida MOSKO, Zv. Rektor për shkencën dhe projektet, Universiteti “Fan S. Noli”

Prof. dr. Gjergji PENDAVINJI, Departamenti i Shkencave Sociale, Universiteti “Fan S. Noli”

Prof. dr. Irena NIKAJ, Departamenti i Edukimit, Universiteti “Fan S. Noli”

Prof. as. dr. Jonela SPAHO, Dekan, Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë, Universiteti “Fan S. Noli”

Dr. Orjon AGO, Zv. Dekan, Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë, Universiteti “Fan S. Noli”

Prof. as. dr. Edlira MENKSHI, Përgjegjëse e departamentit Histori-Gjeografi, Universiteti “Fan S. Noli”

Prof. as. dr. Eris RUSI, Përgjegjës i departamentit Gjuhë-Letërsi, Universiteti “Fan S. Noli”

Dr. Suela DINELLARI, Përgjegjëse e departamentit të Shkencave Sociale, Universiteti “Fan S. Noli”

BORDI ORGANIZATOR

Kristina MANO

Eftiona BYLYKBASHI

Enela BODE

Redaktimi gjuhësor dhe përgatitja për botim: Msc. Eftiona BYLYKBASHI

TABELA E PËRMBAJTJES

FJALË PËRSHËNDETËSE

Lorenc EKONOMI- Rektor i Universitetit “Fan S. Noli”5

FJALË PËRSHËNDETËSE

Erjon NEXHIPI- Kryetar i Këshillit të Qarkut të Korçës7

Gjergji PENDAVINJI

LLAZAR FUNDO DHE LËVIZJA FEDERALISTE PËR NJË EUROPË TË LIRË DHE TË BASHKUAR: MANIFESTI I VENTOTENËS9

Irena NIKAJ

LËVIZJA ANTIFASHISTE NË SHQIPËRI: E MAJTA DHE BANDITIZMI SOCIAL.....22

Elona ÇEÇE

LLAZAR FUNDO SI PERSONAZH HISTORIK NË ROMANIN RIKTHIM NË VENTOTENE (KËNDVËSHTRIM GJUHËSOR DHE LETRAR).....33

Eris RUSI

NGA USTIKA NË VENTOTENE: ZAI FUNDO DHE PETRO MARKO NË FILTRAT E HISTORISË (TË PËRBASHKËTA DHE PARALELE).....45

Viola DOLANI

Denisa TITILI

PERSONALITETI I LLAZAR FUNDOS NË VLERËSIMIN E INTELEKTUALËVE TË KOHËS..... 54

Jonela SPAHO

Ilir SHYTA

SKICAT SATIRIKE TË TIJ: EPISTOLARI I LLAZAR FUNDOS ME FAN NOLIN.....61

I nderuar Kryetar i Këshillit të Qarkut Korçë,

Të nderuar kolegë, studiues, studentë dhe të pranishëm,

Është një kënaqësi dhe një përgjegjësi e veçantë për mua, si përfaqësues i Universitetit, të hap këtë simpozium kushtuar një prej figurave më komplekse, por edhe më frymëzuese të mendimit shqiptar dhe evropian – Lllazar (Zai) Fundo. Kjo veprimtari, e zhvilluar në bashkëpunim me Këshillin e Qarkut, është pjesë e një sërë projektesh dhe bashkëpunimesh që universiteti ynë po ndërmerr për të sjellë në vëmendje figura që kanë kontribuar për dijen, lirinë dhe dinjitetin kombëtar.

Ky simpozium i jep kontekstit historik edhe një dimension simbolik: *Zai Fundo, me idetë e tij, me angazhimin politik dhe intelektual ishte një zë i hershëm i mendimit të lirë evropian, për të cilin sot flasim shpesh, por që rrallë e përjetojmë me të njëjtën thellësi si ai.*

Figura e Fundos përfaqëson kurajën për të menduar ndryshe në kohë të vështira, për të kundërshtuar pa hezitim çdo formë dogmatizmi, për të mbrojtur të vërtetën dhe për të mos u mbyllur në kufijtë e ngushtë të nacionalizmit apo ideologjive të imponuara. Përmes angazhimit të tij në “Manifestin e Ventotenes”, një ndër dokumentet themeluese të mendimit federalist evropian, ai dha një kontribut të vyer për një Evropë pa kufij, të bashkuar në liri, demokraci dhe drejtësi shoqërore. Pikërisht për këtë arsye, studiuesit që do të referojnë sot e kanë një detyrë të rëndësishme: të sjellin Fundon në shumëdimensionet e tij – si publicist, mendimtar politik, aktivist, dhe mbi të gjitha si një figurë e vetëdijshme për kohën dhe përgjegjësinë ndaj saj. Fjala e tyre do ta nxjerrë në pah kompleksitetin dhe aktualitetin e mendimit të tij, duke e bërë këtë simpozium jo thjesht një akt akademik, por edhe një reflektim shoqëror të nevojshëm.

Figura të tilla janë dëshmi të vlerave që përfaqëson qyteti i Korçës – një qytet që nuk është vetëm vendlindja e shkollës së parë shqipe, por

edhe djep i mendimit të lirë, i kulturës qytetare dhe i vizionit përtej kufijve. Korça i la pas shoqet e saj jo rastësisht, por sepse formësoi figura si Zai Fundo, të cilat i dhanë dimension të ri identitetit tonë kolektiv dhe e vendosën atë në një kontekst evropian modern.

Si korçarë, por mbi të gjitha si shqiptarë duhet të ndihemi krenarë për figura të tilla largpamëse si Llazar Fundo, të cilët, megjithëse u përndoqën dhe u sulmuan në kohën kur jetuan, nga pushtuesit dhe regjimet shtypëse, nuk hoqën dorë nga idealet e tyre për një shoqëri të drejtë, të lirë dhe të ndriçuar. Janë pikërisht këta njerëz që, megjithë izolimin dhe dhunën që pësuan, mbollën idetë që më vonë do të lartësoheshin nga koha dhe do të shërbenin si busull për brezat e ardhshëm. Ata janë prova se vlerat e vërteta nuk zbehen nga padrejtësia e momentit, përkundrazi, ato fitojnë peshë dhe dritë me kalimin e kohës. Prandaj, është detyra jonë të mos i harrojmë, por t'i rikthejmë në qendër të kujtesës sonë kolektive, si shembuj të kurajos dhe vizionit për një të ardhme më të mirë.

Për këtë qëllim universiteti ynë ka në qendër të punës së tij krijuese dhe kërkimore studimin e figurave që kanë ndihmuar në ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe të denjë. Për ne, kujtimi dhe analizimi i këtyre figurave është një akt formues, jo vetëm për studentët, por për të gjithë shoqërinë.

Ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe ju uroj një simpozium të suksesshëm dhe frytdhënës.

Faleminderit!

FJALË PËRSHËNDETËSE

Dr. Erjon NEXHIPI- Kryetar i Këshillit të Qarkut të Korçës

I nderuar Rektor i Universitetit “Fan S. Noli”,

Të nderuar studiues dhe pedagogë,

Të respektuar pjesëmarrës,

Është kënaqësi e veçantë për mua, si Kryetar i Këshillit të Qarkut Korçë, t'ju përshëndes në këtë aktivitet shkencor kushtuar një figure të rëndësishme të historisë dhe mendimit shqiptar: Zai (Llazar) Fundo.

Këshilli i Qarkut Korçë është vazhdimisht i angazhuar në mbështetjen e aktiviteteve që synojnë studimin, njohjen dhe vlerësimin e personaliteteve historike dhe kulturore, të cilët kanë kontribuar në mënyrë të qenësishme në pasurimin e trashëgimisë së vendit tonë.

Figura e Zai Fundos është një nga më komplekset dhe më interesante të historisë shqiptare të shekullit XX. Ai është një personalitet që me mendimin e tij të lirë dhe angazhimin intelektual kontribuoi dukshëm në zhvillimet politike, sociale dhe intelektuale të kohës së tij. Korça ka privilegjin të jetë vendlindja e këtij atdhetari dhe intelektualit, jeta dhe veprimtaria e të cilit vazhdon të zgjojë interes dhe diskutime edhe sot. Fundo, megjithëse vinte nga një familje e pasur dhe kishte mundësi të tjera jetese, zgjodhi një rrugë ndryshe: atë të angazhimit aktiv përballë rreziqeve politike dhe sociale të kohës. Ai iu bashkua lëvizjeve progresiste dhe antifashiste, duke e parë qartë fashizmin si kërcënim ndaj lirisë dhe të ardhmes së vendit të tij. Ai ishte plotësisht i vetëdijshëm për rreziqet që i kanoseshin, por kjo nuk e pengoi të mbante qëndrime të forta dhe të vendosura.

Në këto ditë, kur po zhvillohet në Tiranë Samiti i gjashtë i Komunitetit Politik Europian, në kuadër të Javës së Europës, vlen të kujtojmë vizionin europian të Zai Fundos. Ai besonte në një Europë të bashkuar, demokratike dhe progresiste. Për Fundon, pjesa më e ndërgjegjësuar e shoqërisë është ajo që arrin të dalë nga zonat e rehatisë dhe

konformitetit, duke kuptuar realitetin dhe duke bërë zgjedhje të qarta e të guximshme që paraprijnë një të ardhme më të mirë për të gjithë.

Në këtë kontekst, bashkëpunimi me Universitetin “Fan S. Noli” është mjaft domethënës për ne, pasi krijon hapësira për kërkimin shkencor dhe debatet intelektuale, duke kontribuar në formimin e brezave të rinj dhe duke ndikuar në zhvillimin e mëtejshëm social e kulturor të rajonit tonë.

Shpreh besimin se konferenca e sotme do të thellojë njohuritë mbi jetën dhe kontributet e Zai Fundos, duke i bërë këto vlera më të kuptueshme dhe më të afërta për publikun e gjerë.

Ju falënderoj për punën tuaj të çmuar dhe ju siguroj se Këshilli i Qarkut Korçë do të vazhdojë të mbështesë dhe të nxisë nismat që kanë në qendër historinë, kulturën dhe arsimin.

Ju uroj punë të mbarë dhe suksese në punimet e këtij aktiviteti shkencor.

Faleminderit!

LLAZAR FUNDO DHE LËVIZJA FEDERALISTE PËR NJË EUROPË TË LIRË DHE TË BASHKUAR: MANIFESTI I VENTOTENËS

Prof. dr. Gjergji PENDAVINJI

Departamenti i Shkencave Sociale

Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane

Universiteti "Fan S. Noli"

Abstrakt

Llazar (Zai) Fundo është një personalitet i rëndësishëm, mendimtar dhe veprimtar aktiv, veçanërisht në rrethanat komplekse historike, gjatë dy luftërave botërore të shekullit të kaluar, për vendin dhe kontinentin tonë.

Si intelektual, gazetar dhe aktivist politik shqiptar, ai luajti një rol të rëndësishëm në lëvizjen antifashiste dhe ishte një ndër të parët shqiptarë ideatorë të lëvizjes federaliste në kontinentin tonë duke e konsideruar atë si një zgjidhje për të ardhmen e Shqipërisë dhe të Europës.

Llazar Fundoja përfaqëson një veprimtar të shquar dhe elitar që u përfshi aktivisht në lëvizjen ideologjike dhe politike europiane të federalizmit, ku spikati me idetë e tij racionale për një organizim të ri politik të kontinentit si kushti i domosdoshëm për një Europë pa hegjemonizëm, pa konflikte nacionale, pa luftëra dhe për një bashkësi të lirë dhe të unifikuar mbi themelin e federalizmit. Ai, falë formimit dhe kapacitetit të tij, u bashkua me ideologët më progresistë europianë, me protagonistët e projektit politik të Bashkimit European.

Manifesti i Ventotenës, në të cilin Fundo ishte bashkautor, nën titullin "Manifest për një Evropë të lirë dhe të bashkuar" përbën projektin politik më të kompletuar, i hartuar në dimrin e vitit 1941 nën drejtimin e Altero Spinellit dhe Ernesto Rossit, si dhe bashkëpuntorëve të tjerë europeistë, antifashistë të internuar në ishullin e Ventotenës. Ky manifest lindi si një refleksion mbi luftën 30-vjeçare që tronditi Evropën nga 1914 deri më 1945 dhe përbën një ndryshim themelor që bazohej në projektin "për një kontinent evropian të bashkuar". Në shkrimet teorike të këtyre protagonistëve u përcaktuan linjat e një ideologjie koherente për konfigurimin federalist të Europës. Llazar Fundoja ka vendin e merituar në këtë proces të manifestit. Ai u përkushtua

me të gjithë forcën e ideve dhe veprimtarisë politike për realizimin e këtij projekti deri në fundin tragjik të jetës së tij.

Tek ky personalitet shqiptar shohim të unifikuar botëkuptimin progresist europeist dhe vullnetin e fuqishëm deri në vetëmohim për arritjen e këtij qëllimi.

Kjo është një vlerë e jashtëzakonshme që në shikimin e sotëm ka një karakter të theksuar diakronik.

Llazar Fundoja, me jetën e veprën e tij, mbetet një prekursor i shkëlqyer i projektit politik të Bashkimit European, një atdhetar që bën krenar çdo shqiptar sot që aspiron për lirinë dhe prosperitetin e vendit të tij, të Shqipërisë europiane.

Fjalë kyçe: *Llazar Fundo, antifashist, federalizmi european, Manifesti i Ventotenës*

LLAZAR FUNDO AND THE FEDERALIST MOVEMENT FOR A FREE AND UNITED EUROPE: THE VENTOTENA MANIFESTO

Abstract

Llazar (Zai) Fundo was an important personality, thinker and activist, especially in the complex historical circumstances, during the two world wars of the last century, for our country and continent.

As an Albanian intellectual, journalist and political activist, he played an important role in the anti-fascist movement and was one of the first Albanians to conceive the federalist movement on our continent, considering it as a solution for the future of Albania and Europe.

Llazar Fundo represents a prominent and elite activist who was actively involved in the European ideological and political movement of federalism, where he stood out with his rational ideas for a new political organization of the continent as the necessary condition for a Europe without hegemonism, without national conflicts, without wars, and for a free and unified community on the foundation of federalism. Thanks to his training and capacity, he joined the most progressive European ideologists, the protagonists of the political project of the European Union.

The Ventotena Manifesto, of which Fundo was a co-author, under the title “Manifesto for a free and united Europe” constitutes the most complete

political project, drafted in the winter of 1941 under the direction of Altero Spinelli and Ernesto Rossi as well as other Europeanist, anti-fascist collaborators interned on the island of Ventotena. This manifesto was born as a reflection on the 30 years of war that shook Europe from 1914 to 1945 and constitutes a fundamental change that was based on the project: "for a united European continent".

In the theoretical writings of these protagonists, the lines of a coherent ideology for the federalist configuration of Europe were defined. Llazar Fundo has a deserved place in this manifesto process. He dedicated himself with all the strength of his ideas and political activity to the realization of this project until the tragic end of his life.

In this Albanian personality, we see a unified progressive and pro-European worldview along with a strong will, up to self-denial, to achieve this goal. This is an extraordinary value that in today's view has a pronounced diachronic character.

Llazar Fundo with his life and work remains an excellent precursor of the political project of the European Union, a patriot who makes every Albanian proud today, who aspires for the freedom and prosperity of his country, of European Albania.

Keywords: *Llazar Fundo, anti-fascist, European federalism, Ventotena Manifesto*

I. Lëvizja federaliste në Europë dhe Llazar Fundoja

Llazar Fundo, ishte një intelektual erudit, një gazetar i mprehtë dhe aktivist i paepur politik, një shqiptar i devotshëm që luajti një rol të rëndësishëm në levizjen antifashiste dhe njëkohësisht ai mbetet një pararendës i projektit federalist europian.

I lindur në Korçë, më 20 mars 1899 në një familje qytetare patriotike, në rininë e tij u shkollua në Liceun francez të Selanikut (Greqi) dhe më tej përfundoi studimet e larta në Paris (Sorbonë) për jurisprudencë. Falë këtij formimi dhe bagazhi intelektual u kthye në atdhe ku punoi dhe luftoi me përkushtim për zhvillimin e emancipimin e vendit.

Veprimtaria e tij është e gjerë dhe e shumanshme, por këtu do të dëshiroj të ndalem në një përmasë të rëndësishme të veprimtarisë së tij në shërbim të ideimit dhe përpunimit të një diskursi, e më tej të lëvizjes së re europiane si një projekt i domosdoshëm për organizimin politik e shtetëror të kontinentit mbi bazat e federalizmit.

Idetë mbi federalizmin lindën në epokën e revolucioneve të shek.18 në vendet e Europës, e sidomos në Francë. Këto ide ishin në kundërshtim me doktrinën e Tomas Hobsit mbi shtetin e sovranitetin absolut të tij. Hobsi, mendimtar i shekullit të 17-të, konsiderohet si themeluesi i filozofisë politike dhe teorisë së shtetit. Ai, në veprën “Leviathan”, analizoi organizimin politik të shoqërisë në Evropë mbi bazën e shtetit-komb i cili duhet të kishte aftësinë e sovranitetit, Sovraniteti sipas këtij koncepti ishte aftësia e shtetit për të qenë i plotfuqishëm në territorin e tij dhe i pavarur nga shtetet e tjera. Ky sovranitet i çdo shteti duhet të jetë i plotë dhe i paprekshëm. Llazar Fundo në pikëpamjet e tij mbi organizimin shtetëror të shoqërisë evropiane ishte kundër kuptimit të sovranitetit absolut të shtetit dhe përkrahu kritikët e kësaj doktrine të cilët mendonin se procesi i ndërtimit të shtetit federal është një proces i anasjelltë në raport me atë të shtetit nacional me sovranitet absolut. Shteti i modelit federal bazohet në kufizimin e sovranitetit shtetëror në funksionet e brendshme dhe funksionet e jashtme duke decentralizuar pushtetin në favor të një demokracie më të plotë, si dhe duke krijuar një bashkësi politike mbarështetërore për të realizuar paqen. Kjo ishte vlere e re që këta ideologë nismëtarë, ku bënë pjesë edhe Llazar Fundo, përpunuan lidhur me shtetin dhe funksionet e tij. Kjo përbënte themelin e federalizmit.

Mendimi politik federalist fitoi terren dhe u zhvillua nga fundi i shek. XVIII dhe fillimi i shek. XX, por deri në prag të Luftës së Dytë botërore federalizmi nuk kishte marrë formën e një sistemi ideologjik të aftë për të orientuar në mënyrë globale sjelljet politike në Europë. Kjo për faktin sepse mungonte, tek ideatorët e parë, një vizion autonom i qëllimit federalist për arsye se ai kryesisht varej nga objektivat ideologjike ku herë mbështetej një ideator, herë dikush tjetër. Deri në

këtë moment për Llazar Fundon dhe ideatorët e rinj europianë, federalizmi konsiderohej më tepër si një teknikë e organizimit të pushtetit mbështetur në objektivat e një shoqërie demokratike, por ende i paaftë për t'i dhënë jetë një projekti politik autonom. Kjo mangësi u vu në dukje dhe u trajtua në një numër shkrimesh e debatesh tek Llazar Fundo e bashkëpunorët e tij të rrymës së re të federalizmit europian.

Për ideatorët e rinj europianë ishte e domosdoshme përpunimi i një teorie organike dhe koherente mbi federalizmin. Kjo u shoqërua me një numër shkrimesh të botuara në revista e gazeta të vendeve europiane, ashtu sikurse edhe në rajonin e Ballkanit. Kështu revista “La federation ballkanique”, organi i popujve të shtypur dhe minoriteteve kombëtare të Ballkanit, u bë tribunë e përpunimit të mendimit koherent, teorik dhe organik të federalizmit. Ajo botohej në Vienë në tetë gjuhë: frengjisht, bullgarisht, kroatisht, sërbisht, shqip, greqisht dhe turqisht (Fisera, np 1), pra edhe në gjuhën shqipe. Llazar Fundo si intelektual i shquar shqiptar ka drejtuar dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm në publikimet, shkrimet e redaktimet e kësaj reviste periodike.

Tashmë federalizmi filloi të konceptohej si një projekt politik me faza të ndryshme të betejës federaliste. Kjo betejë shërbeu për të identifikuar forcat politike e sociale të afta për të mbështetur format organizative themelore të një lëvizjeje federaliste. Në historinë e mendimit politik, ideatorët e rinj federalistë të Europës u mbështetën tek ideologu amerikan, që ata e konsideronin si themeluesin e teorisë së shtetit federal, Aleksandër Hamilton (1755-1804). Ai ka qenë jurist dhe një lider politik, shpesh i konsideruar si një prej etërve themelues të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe një ndër liderët e Partisë Federaliste (Enciclopedie, oct14, 2024). Në shkrimet e tij (The federalist), ky autor analizonte kushtetutën e Konventës së Filadelfias të 1787, e cila kishte një orientim liberal duke vlerësuar për herë të parë në histori një instrument të përshtatshëm për realizimin e vizionit politik, institucional dhe ekonomik (Daci A,ideo.fed). Në planin politik Hamilton vlerësonte dy nivele të ndryshme qeverisëse, atë federale dhe atë shtetërore me sfera autonome kompetencash, gjë e cila përforconte

garancitë e lirisë së qytetarëve. Gjithashtu ky model kushtetues mbështeste ndarjen funksionale të pushteteve: atij legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, si dhe ndarjen territoriale të pushtetit politik.

Megjithatë në Evropën e shekullit të 19-të ende nuk kishte një qartësim të idesë së Bashkimit European si një projekt politik konkret. Për më tepër modelet e organizimit e jetës ekonomike, sociale dhe kulturore pothuajse ishin të kufizuara në hapësirën nacionale. Për këtë arsye, deri në këtë kohë, ideja e bashkimit european mbetej një ide e papërpunuar mirë nga autorët evropianë me një konception të pamjaftueshëm mbi strukturën, funksionin, qëllimet dhe domosdoshmërinë e institucioneve federale. Të parët ideatorë evropianë ishin Sen Simon dhe Thierry-i (wikirouge.net), të cilët përpunuan një projekt të riorganizimit të shoqërisë europiane. Në këtë ide u bashkuan edhe ideologë të tjerë të cilët sugjeruan aplikimin e federalizmit për të realizuar Evropën e bashkuar. Më tej federalizmi european u konsolidua si një kusht i domosdoshëm edhe nga grupet majtiste në Europë. Ideatori italian Dino Francesko, duke eksploruar teorinë federaliste (Daci A,ideo.fed), konstatoi se sovraniteti absolut i shteteve është shkak i konflikteve dhe i luftimeve dhe kjo kërkon patjetër përhapjen e metodave dhe vlerave liberale tek raportet ndërkombëtare. Ky koncept pati më tepër mbështetje në kontinent duke pranuar se Federata Evropiane ishte instrumenti efikas për të mbrojtur vlerat dhe liberal–demokracinë perëndimore nga sulmet e ideologjive totalitare. Në shek XX gjatë Luftës II Botërore synimi përbashkues për një Europë si një njësi e unifikuar politiko-ekonomike u inspirua nga francezi Robert Schuman (the federal prospect ,113). Ideatorët e parë shtruan çështjen se si Evropa mund të bëhej një hapësirë politike e unifikuar. Kjo çështje hapi një diskurs analitik mjaft produktiv duke evidentuar se Evropa është një bashkim vlerash të përbashkëta, pavarësisht gjuhëve, etnive, kulturave dhe historive të ndryshme dhe shpesh konfliktuale. Reflektimi mbi shkaqet e dy luftërave botërore, të cilat ishin europiane, e bënë të domosdoshëm reformimin dhe riorganizimin politik të kontinentit. Për këtë arsye ideja “Bashkim në

diversitet” u bë jo vetëm slogan, por edhe një program emancipues për Evropën. Ky parashtrim konceptual dhe teorik u bë lejtmotivi kryesor i Llazar Fundos. Ai iu përkushtua me të gjithë fuqinë intelektuale dhe politike përpunimit dhe përhapjes në krejt hapësirën kontinentale, e veçanërisht në Ballkan, të kësaj ideje duke qenë i bindur dhe duke besuar në mundësinë dhe dobinë e realizimit të këtij projekti.

Këto ide dhe ky botëkuptim mbi Evropën e bashkuar ishin temat dhe problematikat që zunë vendin qendror në publikimet e Llazar Fundos dhe të intelektualëve të emancipuar evropianë, ku vizioni federalist i organizimit politiko-shoqëror të kontinentit renditej i pari.

II. Manifesti i Ventotenës dhe Llazar Fundo

Cfarë përfaqëson Ventotena?

Ventotena është një ishull në detin Tirren, në bregun midis rajoneve të Lacios dhe Kampanias. Nga viti 1939 deri në vitin 1943 shumë antifashistë, të majtë e të djathtë, u konsideruan individë “të padëshiruar” nga regjimi i Benito Musolinit dhe u internuan në këtë ishull të vogël. Ndër këta të internuar ishin figura të rëndësishme të mendimit e angazhimit antifashist si: Sandro Pertini (më vonë President i Italisë), Luigi Longo, Umberto Terracini, Alterio Spinelli, Ernesto Rosi etj.. Por, në Ventotene u internuan edhe një grup antifashistësh shqiptarë ku shquhej Llazar Fundo (Laureta Petoshati “Rikthim në Ventotene”).

Ky ishull bashkoi ideatorët dhe intelektualët përparimtarë evropianë antifashistë për të hartuar e përpunuar një projekt të organizimit të ri politik të kontinentit, i njohur si Manifesti i Ventotenës. Manifesti i Ventotenës përbën dokumentin themelor për mendimin federalist evropian i shkruar në vitin 1941 nga një grup intelektualësh evropianë elitare të internuar si: Alterio Spinelli, Ernesto Rossi, Eugenio Kolorni, Llazar Fundo, etj... Ky manifest mban titullin “Për një Evropë të lirë dhe të bashkuar”. Në enciklopedinë Treccani theksohet se “...ky manifest lindi nga refleksionet mbi luftën 30-vjeçare, e cila tronditi

Evropën nga 1914 deri në vitin 1945 dhe përfaqëson një ndryshim themelor në paradigmen e projektit për komunitetin evropian të bashkuar (Enciklopedia Treccani)”.

Përmbajtja e këtij dokumenti të strukturuar me koherencë shpaloste një vizion të ri për një Evropë të bashkuar dhe federale si përgjigje ndaj nacionalizmave që çuan në Luftën e Dytë Botërore dhe për këtë qëllim sugjerohej:

1- Kapërcimi i shteteve kombëtare sovrane.

Autorët e këtij Manifesti argumentonin se ndarja e Europës në shtete—kombe ishte shkaku i konflikteve dhe ata propozonin krijimin e një federate evropiane me një qeveri ndërkombëtare.

2- Bashkimi politik dhe ekonomik i Evropës.

Për të garantuar paqen, ishte i nevojshëm një integrim politik dhe ekonomik, institucione të përbashkëta që do të rregullonin çështjet thelbësore si politika e jashtme dhe mbrojtja.

3- Parime demokratike dhe liri individuale.

Realiteti i ri politik evropian duhej të bazohej në demokraci, në respektimin e të drejtave të njeriut dhe në drejtësinë sociale.

4- Kundërshtimi i totalitarizmave dhe diktaturave.

Manifesti i kundërvihej si fashizmit, ashtu edhe çdo forme tjetër të autotarizmit, duke promovuar një rend të bazuar në liri dhe bashkëpunim.

Struktura e Manifestit përbëhej nga tri pjesë kryesore:

- Kriza e shoqërisë moderne, shkruar nga Spinali
- Bashkimi European pas luftës, shkruar nga Spinali dhe
- Reforma e shoqërisë, shkruar nga Rossi.

Kjo strukturë mbetet ende aktuale dhe në rend të ditës.

Në origjinë të idesë të një federate evropiane kanë qarkulluar në Evropë terrma të tillë që nga fillimi i shekullit të 19-të kur Henri Saint-Simon dhe Auguste Thierry propozuan një model mbikombëtar për organizimin e shoqërisë evropiane. Megjithatë ky ideal nuk ishte kthyer asnjëherë në një lëvizje politike konkrete dhe nuk ishte konsideruar si

një qëllim i arritshëm për brezat e asaj kohe. Ndërsa në Ventotene shohim që teoria e shtetit federal e konceptuar nga Spineli dhe Rossi së bashku me veprimin politik që e shoqëroi pati një ndikim të thellë në shoqërinë e kontinentit duke u përqëndruar brenda mendimit politik realist.

Në këtë dokument, Federata e Shteteve të Bashkuara të Evropës, sipas modelit amerikan konsiderohej si e vetmja zgjidhje për shpëtimin e qytetërimit evropian. Kështu, në këtë momente termi “Shtetet e Bashkuara të Evropës” nuk ishte më një koncept ideologjik apo kulturor, por tashmë një qëllim konkret politik. Ideatorët e manifestit mendonin se ky projekt kishte nevojë për veprim politik duke e konsideruar federalizmin evropian si standart për të gjykuar forcat politike tradicionale. Duke analizuar shkaqet që çuan në dy luftërat botërore Manifesti hodhi poshtë pacifizmin pasiv të doktrinės liberale dhe propozoi pacifizmin aktiv, bazuar në nevojën e një sistemi të ri politik për Evropën, të ndërtuar mbi ndërvartësinë e shteteve dhe jo mbi ekuilibrin midis tyre. Në këtë kontekst kjo teori e shtetit federal pati një ndikim të thellë në historinë europiane si një mendim politik realist.

Ky dokument i shkruar në kushte internimi hodhi themelet për integrimin evropian dhe ndikoi fuqimisht procesin e krijimit të bashkimit Evropian. Në një pikëpamje strategjike Manifesti i Ventotenes përcaktoi linjat ideologjike koherente federaliste të Europës. Tashmë Federata Europiane konfigurohet si një objektiv politik konkret i realizueshëm. Kjo ishte zgjidhja më e mirë për të shmangur ngjarjet tragjike të dy luftërave botërore. Me anën e kapërximit të modelit të shtetit nacionalist si një model që pengon civilizimin. Gjithashtu u formua bindja se Federata Europiane nuk është vetëm e mundshme, në këtë fazë historike, por edhe e domosdoshme për të shmangur konfliktet nacionale, autoritarizmin, luftën e mjerimin dhe për të siguruar emancipimin njerëzor, progresin, paqen, drejtësinë sociale në hapësirën e kësaj Federate.

Duhet evidentuar se në këtë proces, veçanërisht në Ventotene dhe Manifestin për një Europë të lirë dhe të bashkuar, një rol dhe kontribut

të padiskutuar dhe të çmuar ka patur personaliteti ynë i shquar shqiptar Llazar Fundo. Ky kontribut pasqyrohet qartësisht në shkrimet,,në veprimtarinë e shumanshme të tij por akoma më tepër paraqitet nga dëshmitë e personaliteteve të shquara italiane e europiane të internuar në këtë ishull. Në shkrimet e Sandro Pertinit (ish-president i Italisë), Alterio Spineli, Ernesto Rossit etj përshkruhen mjaft qartë aftësitë intelektuale dhe shpirti vetmohues i Llazar Fundos, vlerat e tij morale, formimi, shkollimi dhe kontributi i madh në procesin e përpunimit dhe redaktimit të Manifestit.

Në dëshmitë e tyre theksohet se Llazar Fundo, ka patur një kontribut të rëndësishëm intelektual tek Manifesti i Ventotenes (Fjalori enciklopedik Treccani).

Politikani Alterio Spineli, federalist evropian dhe një nga themeluesit e Bashkimit Evropian në autobiografinë e tij e vlerëson shumë Llazar (Zai) Fundon si "...autoritar, me përvojë politike të gjatë dhe komplekse. Besimit të tij i shtohet inteligjenca dhe njohja jo pak e gjuhëve. Përkushtimi politik i Fundos ishte përtej Shqipërisë edhe kur u arrestua Gjergj Dimitrovi për djegjen e Rajshtagut,Fundoja ishte bashkëpunëtor i tij. Për t'i shpëtuar arrestimit shkoi në Moskë...më vonë i shkëputi marrëdhëniet me internacionalen,teksa përndiqej prej saj. Ai ishte i edukuar në një klimë kulturore liberale ...Në Ventotene shëtiste i qetë, i drejtë,i bukur me flokët bjond që ja merrte era, duke mërmëritur me zë të ulët fjalët e Platonit që ishte duke e lexuar në greqisht," (Spineli, f. 265-267)

Një tjetër antifashist ish i internuar në Ventotene, Riccardo Bauer jep këtë dëshmi për mikun e tij Llazar Fundo: "...pata një njohje simpatike me një gazetar shqiptar,Llazar Fundo, i cili donte që ëndrra e tij për emancipim të ishte pasojë e një praktike të lirë dhe jo e një imponimi të egër, burokratik siç e kishte parë të realizuar në Rusi. I pajisur me një inteligjencë të mprehtë,kishte një vizion historik të asaj që po ndodhte në Evropën Lindore dhe në Rusinë aziatike që ishte jashtëzakonisht interesante,besonte në një zhvillim të nevojshëm progresiv demokratik të regjimit bolshevik edhe pse do të zgjaste në

kohë. „, e shfaqte këtë siguri duke ilustruar procesin me të cilin Rusia komuniste kishte ngjallur një fermentim inovator në vendet e Azisë Qendrore që ajo mbikqyrte... Kur e lashë Ventotenen e përshëndeta Fundon me shpresën se do të takoheshim përsëri një ditë me të,sepse me të mund të diskutoja për atë faktor thelbësor të historisë që është revolucioni rus,duke gjetur një bisedues pa qëndrime fanatike mendore dhe një vëzhgues kritik me një gjykim të qetë për realitetin e tanishëm të një ngjarjeje, të cilën e vlerësonim të kishte rëndësi historike pozitive. Shpresë e kotë sepse siç mësova më vonë Fundoja u kthye në Shqipëri ku mori pjesë aktivisht dhe heroikisht në çlirimin e atdheut të tij nga nazistët,por kur fitorja erdhi u ftua nga komunistët të kthehej në parti,ai e refuzoi ftesën dhe u vra në burgun ku ishte mbyllur.” (Riccardo Bauer, fq. 130-131.)

Vdekja barbare e Llazar Funos tronditi shumë bashkëluftëtarët e tij antifashistë,miqtë e vërtetë dhe pesonalitetet e fuqishme të Evropës të lirë dhe të bashkuar. Ernesto Rossi e kujton kështu Llazar Fundon: “E kisha marrë me dhimbje të madhelajmin e vdekjes së Fundos. Ishte njeri bujar,inteligjent,që mund të kishte dhënë një kontribut të rëndësishëm në rindërtimin e vendit të tij,në se bota nuk do të shkonte në rënim ashtu siç po shkon...” (Ernesto Rossi, fq. 64) mbështetur në burimet e shfrytëzuara dhe analizat.

III. Përfundime

Mbështetur në burimet e shfrytëzuara dhe analizat e bëra mbi këto të dhëna rezulton se Zoti Llazar (Zai) Fundo ka luajtur një rol të rëndësishëm në ideimin dhe përhapjen në Shqipëri, në rajonin e Ballkanit por edhe më gjërë të ideve federaliste të cilat u përpunuan nga mendimtarët evropianë për gjatë dy luftrave botërore, Ai kishte aftësitë dhe formimin e duhur për të argumentuar dhe publikuar idenë se federalizmi ishte e vetmja zgjidhje për një kontinent të lirë të bashkuar,në paqe dhe të civilizuar. Në këtë perspektivë ai e shikonte,por edhe ishte i bindur, se kjo ishte njëkohësisht edhe rruga e zhvillimit të Shqipërisë evropiane. Këtij qëllimi Llazar Fundo ja

dedikoi gjithë veprimtarinë e tij politike dhe intelektuale deri në fundin tragjik të jetës së tij. Kështu, tek ky person shohim një shqiptar, që në kushtet historike të rajonit dhe Shqipërisë, të ecë më shpejt se koha në idetë emancipuese dhe veçanërisht në idenë dhe projektin federalist evropian.

Ashtu sikurse ideatorët e parë, zoti Fundo mbështeti çështjen e krijimit të një hapësire evropiane si një hapësirë politike të unifikuar. Kjo ishte e mundur për faktin se Evropa ishte një bashkim vlerash të përbashkëta, pavarësisht gjuhëve, etnive, kulturave dhe historive të ndryshme por edhe shpesh konfliktuale. Prandaj programi politik “Bashkim në Diversitet” u bë rruga e sigurt për emancipimin e Europës. Këtij programi ju dedikua tërësisht Llazar Fundo.

Momenti historik, ku spikati me gjithë talentin, aftësitë intelektuale, karakterin dhe vullnetin e tij, si patriot i devotshëm dhe antifashist i vendosur ishte kontributi i tij i shquar në ishullin e Ventotenes, në Itali, i internuar nga fashizmi. Ai u bashkua me intelektualët evropiane të cilët ndodheshin të internuar në këtë ishull. Lëvizja politike federaliste shënoi pikën kulmore me hartimin e programit politik të “Manifestit të Ventotenes: Për një Evropë të lirë dhe të bashkuar”. Ky Manifest përbën dokumentin themelor për mendimin federalist evropian i shkruar në vitin 1941 nga një grup intelektualësh evropianë elitarë të internuar midis të cilëve Llazar Fundo. Kontributi i jashtëzakonshëm i zotit Fundo, si intelektual i kompletuar dhe elitar në radhën e prekursorëve të projektit të Bashkimit Evropian dëshmohet botërisht në dokumentacionin e kohës. Këto dëshmi të shumta, konfirmojnë se zoti Llazar (Zai) Fundo është një shqiptar i shquar, pararendës i Bashkimit Evropian.

Bibliografia

1. Fisera, Vladimir Claude: “Communisme et integration supernationale: Revue La federation balcanique 1924-1932” botuar në Revue d: histoire moderne et contemporaine, tome 34 Nr 3
2. Pertini Sandro: Come ho tentato di diventare saggio” Ventotene 1939-1943

3. Ernesto Rossi, Epistolario 1943-1967, dal Partito d'Azione al centro sinistra, a cura di M. Franzinelli, Laterza, Roma-Bari 2007, fq. 64)
4. Riccardo Bauer, Quelle che hafatta. Trant anni di lote e di ricordi, a cura di Malvezzi E. M. Melino, Presentazione di A. Colombo, Cariplo-Laterza, Milano-Bari, 1987, fq. 130-131.)
5. Alterio Spinelì "Come ho tentato di diventare saggio" Ventotene 1939-1943, fq. 265-267)
6. Laureta Petoshatit: "Rikthim në Ventotene", 2012, Genre Novel
7. Daci Alban: Lindja e ideologjisë federaliste. Thursday, may 20, 2010
8. The federal prospect of federalism in the Schuman declaration. The federalist, Year XI.II, 2000, novembre 2, page 1113
9. Enciclopedia de l'histoire du monde, oct 14, 2024
10. Fjalori Enciklopedik Treccani
11. Pitsos Nicolas: Peuples des Balkans, federez-vous; projets pour une resolution pacifique de la question d'Orient au tournant du XX-e siecle, Cahier Balkanique, 44/2016
12. Bled Jean-Paul et Deschodt Jean-Pierre, 2014 "Les guerres balkaniques 1912-1913," Paris: Presses de l'universite Paris-Sorbonne
13. Daminova Jivka 1989 "La federation contre l'alliance militaire: les socialistes balkaniques et les guerres balkaniques 1912-1913"; Le mouvement social nr 147, p. 69-85.
14. Daci Alban: Lindja e ideologjisë federaliste. Thursday, may 20, 2010

LËVIZJA ANTIFASHISTE NË SHQIPËRI: E MAJTA DHE BANDITIZMI SOCIAL

Prof. dr. Irena NIKAJ

Departamenti i Edukimit

Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë

Universiteti “Fan S. Noli”

“Kujtesa është mburoja më e fortë kundër përsëritjes së të keqes.”

(Primo Levi,

**i mbijetuar nga kampi i Aushwitzit
dhe shkrimtar italian shquar)**

Ky punim ka për objekt shqyrtimi, si fillim, nisur nga nevoja për të hedhur dritë mbi fenomenin e “revolucionit që ha bijtë e vet”, rastet e ekzekutimeve të hapura apo të maskuara, gjatë Luftës Antifashiste Shqiptare, të disa prej figurave të lëvizjes antifashiste, të shkolluar dhe diplomuar në Perëndim, midis tyre, edhe Lllazar-Zai- Fundo.

Në këtë punim duam të zhvillojmë një shqyrtim, i cili ka për synim të tregojë se shfaqje të banditizmit social dhe politik gjatë Luftës Antifashiste Shqiptare sollën eliminimin e pjesës më liberale dhe demokratike, gjë që krijoi kushte për forcimin e pjesës më të dhënë pas pushtetit pas mbarimit të Luftës, por jo vetëm kjo, por janë shfaqur jo rallë, premisa që Lufta Antifashiste të emërtohej luftë civile, gjë e cila nuk mund të qëndrojë në raste të izoluar, por me një kusht, që krimet e kryera për pushtet apo për të bashkëpunuar me pushtuesit e huaj, duhet të dalin në dritë; Lufta Antifashiste ka heronjtë, më të rëndësishmit, e më tej, kriminelët, hajdutët dhe kuislingët, por që nuk janë pjesa domethënëse e saj, përkundrazi, populli shqiptar u rreshtua në krah të historisë, e mundi nazifashizmin dhe e çliroi vendin.

Fjalë kyç: ndryshimet shoqërore, banditizmi dhe banditi social, fashizmi/nazizmi, e majta

1. Kuptimi për banditizmin social dhe aktorët e Luftës Antifashiste në Shqipëri

Banditizmi social është një koncept në historinë sociale dhe kriminologji që i referohet një forme sjelljeje devijante dhe të jashtëligjshme që konsiderohet kriminale nga autoritetet ligjore dhe shtetërore, por shpesh shihet si legjitime, morale ose edhe heroike nga një segment më i gjerë i shoqërisë (shpesh të shtypur). Këta individë ose grupe zakonisht veprojnë në shoqëri rurale, para-industriale ose kufitare që po kalojnë trazira të rëndësishme sociale dhe ekonomike.

Një nga trajtimet më të spikatura i përket Eric Hobsbawm (2022), së pari, se çfarë kuptojmë me bandit social: banditi social është një lloj specifik grabitësi dhe personi devijant, i jashtëligjshëm, por që nuk shihet nga shoqëria e gjerë fshatare si një kriminel i zakonshëm. Në vend të kësaj, këto figura shpesh konsiderohen si heronj, kampionë të drejtësisë sociale, luftëtarë kundër padrejtësive dhe autorë të akteve primitive lokale të rezistencës. Ata veprojnë jashtë ligjit, por shpesh mbrohen dhe mbështeten nga komunitetet e tyre.

Banditizmi social si një fenomen parapolitik: Hobsbawm argumenton se banditizmi social është zakonisht një formë "arkaike" ose "parapolitike" e protestës sociale, që shfaqet në shoqëritë rurale, tradicionale që përballen me shtypje, vështirësi ekonomike ose çënim të pushtetit modern shtetëror. Këta banditë veprojnë si një formë rezistence përpara se të marrin formë lëvizjet më të organizuara politike (si revolucionet fshatare ose partitë politike moderne).

Tipologjia e banditëve socialë: Hobsbawm identifikon disa lloje të banditëve socialë, duke përfshirë:

Grabitësi zemërgjerë: Figura klasike e "Robin Hudit" që vjedh të pasurit për t'ua dhënë të varfërve, duke mishëruar një ndjenjë drejtësie dhe paanësie.

Ekzekutorët që vënë drejtësi: Banditë të shtyrë nga dëshira për hakmarrje kundër padrejtësive ose shtypësve të caktuar, shpesh të karakterizuara nga egërsia e tyre.

Haidukët, kaçakët (ose figura të ngjashme në kultura të tjera): Banda më të organizuara, ndonjëherë me një tipar më të fortë rezistence kundër sundimtarëve të huaj ose kombëtarë, që shpesh gjenden në rajone kufitare ose malore. Shembujt përfshijnë haidukët ballkanas, dakoitët indianë dhe cangaçeiros brazilianë.

Marrëdhënia me shoqërinë fshatare: Një aspekt thelbësor i banditizmit shoqëror është marrëdhënia simbiotike midis banditit dhe komunitetit fshatar. Banditët shpesh mbështeten te popullsia lokale për strehim, furnizime dhe informacion, dhe nga ana tjetër, ata mund të ofrojnë mbrojtje ose një formë drejtësie të ashpër.

Miti dhe Realiteti: Hobsbawm eksploron se si veprat e banditëve shoqërorë shpesh ekzagjerohen dhe mitizohen në balada, legjenda dhe përralla popullore, duke i transformuar ato në figura legjendare. Ai pranon vështirësinë në ndarjen e fakteve historike nga folklori.

Kushtet për shfaqje dhe rënie: Banditizmi shoqëror tenton të lulëzojë në kohë trazirash shoqërore, krizash ekonomike, kontrolli të dobët shtetëror ose kur kërcënohen mënyrat tradicionale të jetesës. Zakonisht bie me forcimin e pushtetit shtetëror, modernizimin dhe ngritjen e formave më të organizuara të veprimit shoqëror dhe politik.

Në thelb, kur shqyrtojmë këtë fenomen nuk ka të bëjë thjesht me histori banditësh, por një analizë historike dhe sociologjike rreth fenomenit të banditizmit shoqëror. Hobsbawm përdor shembuj historikë nga e gjithë bota (si Robin Hood, Jesse James, Pancho Villa, Lampião dhe figura të ndryshme më pak të njohura) për të ilustruar argumentet e tij rreth natyrës, funksionit dhe rëndësisë së këtyre të personave të jashtëligjshëm brenda shoqërive të tyre përkatëse, ne i kushtojmë vëmendje shoqërisë shqiptare dhe fenomeneve të ngjashme me banditizmin gjatë Luftës, por inercia e mbajtjes së pushtetit me çdo kusht dhe me çdo çmim vazhdoi edhe pas 1944.

2. Lëvizja Antifashiste në Shqipëri

Aktorët pjesëmarrës në analizën makro dhe mikro shfaqen si më poshtë:

Duke analizuar Luftën Nacionalçlirimtare Shqiptare (1941-1944) përmes thjerrëzës së aktorëve makro dhe mikro, jepet një kuptim më i thellë i kompleksitetit të kësaj periudhe historike.

2.1.E majta shqiptare: Lëvizja e majtë në Shqipëri ka një histori komplekse dhe domethënëse, të formësuar shumë nga ngritja dhe rënia e komunizmit.

Rrënjët e hershme dhe ngritja e komunizmit (Para Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1944):

- Fillimi i shekullit të 20-të: Ndërsa dolën lëvizjet e hershme demokratike dhe nacionaliste, një lëvizje e dallueshme "e majtë" në kuptimin modern u materializua ngadalë. Figura si Fan S. Noli, një peshkop ortodoks i arsimuar në Amerikë, udhëhoqi një qeveri liberal-demokratike në vitin 1924 me një program radikal të reformës së tokës dhe zhvillimit modern shoqëror, i cili mund të konsiderohet një përpjekje progresive, megjithëse jo shprehimisht komuniste, me prirje të majta.
- Formimi i Partisë Komuniste: Partia Komuniste e Shqipërisë (PKSh): Kjo parti, nën drejtimin e Enver Hoxhës, luajti një rol vendimtar makro në organizimin dhe udhëheqjen e Lëvizjes Nacionalçlirimtare (LNÇ). Ideologjia e tyre politike, struktura organizative dhe strategjitë ushtarake ndikuan ndjeshëm në rrjedhën e luftës. Aftësia e tyre për të organizuar dhe mobilizuar pjesë të mëdha të popullsisë i bëri ata një aktor kryesor makro. Partia Komuniste Shqiptare (më vonë e riemëruar Partia e Punës së Shqipërisë (PPSH), u formua zyrtarisht më 8 nëntor 1941, me ndihmën dhe mbështetjen e komunistëve jugosllavë. Figurat kryesore të hershme përfshinin Enver Hoxhën, Qemal Stafën, Vasil Shanton dhe Ymer Dishnicën.
- Lëvizja Nacionalçlirimtare (LANÇ): Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Partia Komuniste e Shqipërisë udhëhoqi Lëvizjen

Nacionalçlirimtare (LANÇ), një organizim i gjerë rezistence antifashiste. Kjo lëvizje fitoi mbështetje të konsiderueshme popullore dhe luajti një rol të rëndësishëm në çlirimin e Shqipërisë nga pushtimi i fuqive nazifashiste në vitin 1944. Kjo periudhë e forcoi pozicionin e Partisë Komuniste si forca kryesore politike.

2.2.Udhëheqësit lokalë dhe figurat me ndikim

Këta ishin luftëtarët e bazës, përgjithësisht me origjinë fshatare, që kryenin operacionet e përditshme të rezistencës. Guximi, sakrificat dhe njohuritë e tyre vendase ishin thelbësore për suksesin e LANÇ. Individë si Myslim Peza dhe Baba Faja Martaneshi, të cilët gëzonin respekt dhe kishin ndikim lokal, luajtën rol vendimtar në mobilizimin e mbështetjes për rezistencën. Veprimet dhe vendimet e tyre në nivel lokal patën ndikim të rëndësishëm në përpjekjet e përgjithshme të luftës.

2.3.Qytetarët e zakonshëm shqiptarë

Popullsia civile, e cila duroi vështirësitë e okupimit dhe luftës, luajti një rol jetësor në mbështetjen e rezistencës. Sigurimi i tyre me ushqim, strehim dhe informacion ishte thelbësor për mbijetesën e partizanëve. Peizazhi kompleks moral i luftës ndikon ndjeshëm në shfaqjen dhe perceptimin e individëve që mund të konsiderohen banditë shoqërorë. Lufta krijon një mjedis ku individët mund të veprojnë jashtë ligjit, ndërsa pretendojnë se veprojnë në interes të komunitetit të tyre. Perceptimi i këtyre individëve si "banditë socialë" varet nga konteksti dhe perspektivat e atyre që janë të përfshirë. Peizazhi moral kompleks i luftës e bën të vështirë aplikimin e etiketave të thjeshta si "kriminel" ose "hero". Në thelb, lufta prish kornizat tradicionale morale, duke krijuar një zonë gri ku veprimet e individëve janë subjekt i interpretimeve të ndryshme. Pasojat e luftës mund të komplikojnë më tej vlerësimet morale.

Individët që përfshihen në veprimtari të dyshimta gjatë konfliktit mund të shihen si heronj ose banditë, në varësi të klimës politike mbizotëruese dhe raportit të forcave. Procesi i pajtimit dhe drejtësisë ishte dhe është edhe në ditët tona, i mbushur me sfida, pasi shoqëria shqiptare përballet, ende pa përgjigjet adekuate, me trashëgiminë e dhunës së kohës së luftës.

3. Në Luftë si në Luftë-bien heronj më trimat?!

Gjatë Luftës së Dytë Botërore (1941-1944), Shqipëria ishte nën pushtim (fillimisht italian, pastaj gjerman) dhe grupe të ndryshme rezistence ishin aktive. Kjo periudhë u shënua nga konflikte të ashpra, jo vetëm kundër forcave pushtuese, por edhe midis fraksioneve rivale shqiptare. Vrasjet pa gjyq, ose dënimet me vdekje pa vendim gjykate, ishin për fat të keq një realitet i zymtë gjatë kësaj kohe.

Kush vrau kë?

3.1. Lëvizja Antifashiste Nacionalçlirimtare (LANÇ) / Partizanët komunistë

Natyra e konfliktit: Lëvizja Antifashiste(LANÇ) e udhëhequr nga komunistët zhvilloi një luftë guerile kundër pushtuesve nazifashistë dhe bashkëpunëtorëve të tyre shqiptarë. Ashtu si me shumë lëvizje partizane në kohë lufte, ato vepronin jashtë kornizave të përcaktuara ligjore.

Shënjestrat: Individë të akuzuar për bashkëpunim me pushtuesit (italianë, pastaj gjermanë), anëtarë të grupeve rivale nacionaliste (si Balli Kombëtar dhe Legaliteti), spiunë dhe ata që konsideroheshin "armiq të popullit" nga udhëheqja komuniste shpesh ekzekutoheshin menjëherë. Këto ekzekutime ishin pjesë e strategjisë së tyre për të eliminuar opozitën dhe për të konsoliduar pushtetin.

Shkaku-shkaqet (nga perspektiva e tyre): Komunistët i shihnin këto veprime si masa të nevojshme në një luftë brutale për çlirim kombëtar

dhe vendosjen e një rendi të ri politik. Ata shpesh i portretizonin të vrarët si tradhtarë ose fashistë.

Intensiteti: Njohim persekutimin dhe vrasjen e Mustafa Gjinishit, Llazar Zai Fundos, Ramize Gjebresë, etj, ndërsa sa është numri i tyre, është e vështirë për t'u përcaktuar për shkak të natyrës kaotike të luftës dhe kontrollit të regjimit komunist mbi narrativat historike, vrasje të tilla ishin të konsiderueshme dhe kontribuan në numrin e lartë të viktimave civile gjatë luftës.

3.2. Grupet Nacionaliste (Balli Kombëtar, Legaliteti)

Natyra e konfliktit: Këto grupe ishin gjithashtu antipushtues në parim, por shpesh përplaseshin me partizanët komunistë, veçanërisht ndërsa lufta përparonte dhe komunistët fitonin forcë dhe terren. Ata ndonjëherë bashkëpunuan me forcat pushtuese kundër komunistëve, duke e komplikuar më tej pozitën e tyre.

Objektivat: Anëtarët e rezistencës komuniste, ata që i simpatizonin ata, ose individët që perceptoheshin si kërcënime për agjendën e tyre nacionaliste ishin gjithashtu subjekt i vrasjeve jashtëgjyqësore.

Intensiteti: Ndërsa këto grupe u angazhuan në ekzekutime të shpejta, shkalla dhe natyra sistematike e veprimeve të tilla ishin përgjithësisht më pak të gjera se ato të kryera nga partizanët komunistë, veçanërisht pasi komunistët u bënë forca dominuese. Edhe grupet nacionalsite kanë detyrim një veprim i natyrës morale ta realizojnë-faljen atyre që iu morën jetën.

3.3. Forcat Pushtuese (italiane dhe gjermane) dhe bashkëpunëtorët e tyre vendas

Reprezaljet dhe kundërkryengritja: Forcat pushtuese italiane dhe më vonë gjermane, së bashku me bashkëpunëtorët e tyre vendas (si njësitë e formuara nga Balli Kombëtar pas marrëveshjes së tyre me gjermanët), gjithashtu kryen ekzekutime të shpejta si raprezalje për sulmet partizane ose si pjesë e operacioneve të tyre kundër

kryengritjeje partizane. Civilët e dyshuar për ndihmë të rezistencës ishin veçanërisht të goditur.

3.4. Zbulimi i krimeve: Sfidat në dokumentacion dhe kujtesë

Mungesa e të dhënave zyrtare: Për shkak të kushteve të kohës së luftës dhe natyrës së vrasjeve jashtëgjyqësore, vendimet zyrtare të gjykatës ose të dhënat e hollësishme mbaheshin rrallë.

Narrativa komuniste e Pasluftës: Pas vitit 1944, regjimi komunist shtypi çdo narrativë alternative të luftës, duke kontrolluar me përpikëri të dhënat historike. Kjo e bëri jashtëzakonisht të vështirë diskutimin ose hetimin e hapur të mizorive të kryera nga komunistët fitimtarë. Shumë viktima u etiketuan thjesht si "armiq" dhe vdekjet e tyre mbetën të papranuara ose të justifikuara.

Debate të vazhdueshme: Edhe sot, ka debate dhe përpjekje të vazhdueshme për të zbuluar të vërtetën e plotë rreth viktimave të dhunës politike gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe epokës pasuese komuniste në Shqipëri. Periudha 1941-1944, veçanërisht fundi i luftës dhe konsolidimi i pushtetit komunist, u pasua me një numër të konsiderueshëm njerëzish të vrarë pa proces të rregullt ligjor.

Në thelb, periudha 1941-1944 në Shqipëri ishte një kohë brutale kur sundimi i ligjit mungonte kryesisht, dhe fraksionet politike dhe ushtarake, përfshirë partizanët komunistë, u angazhuan në ekzekutime të shpejta si një mjet lufte, kontrolli dhe eliminimi të rivalëve.

Por një gjest i natyrës morale ka nevojë të shfaqet-**falja**.

Një ambasador gjerman, në emër të qeverisë gjermane, një 6 korrik, në Borovë, iu kërkoi falje shqiptarëve të sotëm, për masakrën e Borovës; shqiptarët e sotëm kanë nevojë për aktin e faljes, si përgjegjësi dhe si akt i lartë njerëzor, por edhe angazhim për të mos u përsëritur.

4. Mund ta zgjidhim se kur u largua ushtari gjerman i fundit

Pas faljes, kemi nevojë për shqyrtime shkencore, jo vetëm dokumentare, por të mbështetura në filozofinë dhe sociologjinë e historisë.

4.1. Tek Filozofia kritike më shumë, përmes fokusimit tek qasja më moderne (e spikatur në shekullin e 20-të), që merret me metodologjinë, epistemologjinë dhe themelet konceptuale të hetimit historik. Ajo shqyrton se si historianët ndërtojnë njohuritë rreth së kaluarës.

Shembuj: Shqyrtime rreth shpjegimit historik (shkakësia, mekanizmat), objektivitetit në shkrimin historik, natyrës së provave historike, rolit të rrëfimit dhe marrëdhënies midis fakteve historike dhe interpretimit.

Metodologjia: Përfshin analizën logjike, sqarimin konceptual dhe shqyrtimin e praktikave historike.

4.2. Sociologjia e Historisë (ose Sociologjia Historike)

Sociologjia e historisë, ose sociologjia historike, është një fushë ndërdisiplinore që zbaton teoritë, konceptet dhe metodat sociologjike në studimin e fenomeneve historike. Ajo përdor të dhëna historike për të kuptuar se si janë zhvilluar shoqëritë me kalimin e kohës, si ndryshojnë dhe riprodhohen strukturat shoqërore dhe si ndikojnë proceset historike në të tashmen. Në fokus të sociologjisë së historisë është identifikimi i modeleve, mekanizmave dhe proceseve shoqërore që veprojnë nëpër periudha të ndryshme historike ose brenda konteksteve specifike historike. Ka më pak të bëjë me "kuptimin" e historisë dhe më shumë me "si" dhe "pse-të" e ndryshimit dhe vazhdimësisë shoqërore.

Shembuj:

- Studimi i Max Weber mbi etikën protestante dhe frymën e kapitalizmit për të kuptuar origjinën e kapitalizmit modern.
- Vepra e Norbert Elias mbi "procesin civilizues" dhe zhvillimin afatgjatë të sjelljeve dhe formimit të shtetit.

- Analiza historike krahasuese e revolucioneve nga Theda Skocpol.

Studime mbi zhvillimin afatgjatë të shteteve, klasave shoqërore, marrëdhënieve gjinore ose sistemeve globale.

- Përmes analizës krahasuese:

Shpesh krahason shoqëri ose raste historike të ndryshme për të identifikuar ngjashmëritë dhe ndryshimet.

- Gjurmimi i procesit: Shqyrton sekuencat dhe mekanizmat shkakësorë me kalimin e kohës.
- Mbështetja në të dhënat historike: Përdor burime historike parësore dhe dytësore, por i interpreton ato përmes kornizave teorike sociologjike (p.sh., teoritë e pushtetit, klasës, institucioneve shoqërore, lëvizjeve shoqërore).
- Theksi në strukturat shoqërore: Përqendrohet në strukturat shoqërore të nivelit makro, institucionet dhe aktorët kolektivë, në vend që kryesisht të ketë veprime individuale ose ngjarje unike (megjithëse pranon agjencinë dhe agjencitë).

Në mbyllje, duke patur mundësinë për të shkruar për këto çështje, mendoj, se sado vonë, drejtësi duhet doemos të ketë, kjo do të ndryshojë **kulturën e ngulitur të pandëshkueshmërisë**, sidomos për ngjarje të cilat kanë formësuar shoqërinë dhe politikën në Shqipëri, të kaluarën dhe, natyrisht, na lejojnë të ndërtojmë perspektiva më afër organizimeve shoqërore moderne.

Bibliografi

Elias, N. 2000. The Civilising Process. Wiley-Blackwell Publishing.

Hobsbawn, E. 2022. Banditët-Banditizmi shoqëror në epokën moderne. Tiranë: Pika pa sipërfaqe.

Kadare, I. 1986. Koha e shkrimeve: Viti i mbrapshtë. Tiranë: Naim Frashëri.

Nikaj, I. (2023). Social Theory and Modern Society in Social Networks, Sociological Lens 4 (No: 1), pp. 178-190.

Nikaj, I. The Sociological Study of the Concept of Generations: Journal Demography, 2021-10-24 | Journal article, 23086491.

Nikaj, I. Principle of relevant knowledge in New Century-International Scientific 1st Conference Early Childhood Education and Care Challenges and Perspectives, UNIKO June 2020, ISBN 978-9928-4568-3-0.

Nikaj, I. Ideology, State and Law in Albania (1945-1990). Instituti i Studimeve Politike (ISP). Tiranë 2020, EMAL, ISBN: 978-9928-4592-8-2.

Nikaj, I. 2013. Albanian Social and Philosophical Thinking of the 30s – Neoalbanianism, Author House, Bloomington, IN 47403, and ISBN: 978-1-4772-8183-3, Library of Congress Control Number: 2012919701.

Skocpol, Th. 1979. State and Social Revolution. Cambridge: University Press.

Weber, M. 2004. Etika protestante dhe shpirti i kapitalizmit. Tiranë: Plejad

**LLAZAR FUNDO SI PERSONAZH HISTORIK NË ROMANIN
“RIKTHIM NË VENTOTENE”
(KËNDVËSHTRIM GJUHËSOR DHE LETRAR)**

Prof. as. dr. Elona ÇEÇE (BIBA)

Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë

Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë

Universiteti “Fan S. Noli”

Abstrakt

Shkrimtarja Laureta Petoshati, ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në trajtimin letrar të një teme me vlera të mëdha historike, shoqërore dhe ndërkombëtare – internimet politike në ishullin Ventotene, përmes veprës së saj "Rikthim në Ventotene.", ku spikat në mënyrë të veçantë personazhi historik Llazar Fundo.

Në këtë kumtesë, synohet analiza e kësaj figure historike, duke pasur një këndvështrim gjuhësor, që realizohet me:

1. Identifikimin e gërshetimit mjeshtëror të ligjëratës së drejtë me ligjëratën e zhdrejtë.

II. Analizën e faktit se “ndodhia gjuhësore” karakterizohet nga një harmoni e bashkëveprimit të linjave” Pal Leka” dhe “Llazar Fundo”, ku linja e parë, shërben si kontekst, ku zbërthehet linja e dytë.

Konkretisht, zbërthimi i linjës “Fundo” karakterizohet nga këto veçori:

a. realizimi i spektrit të plotë të elementeve të një personazhi historik, si: identiteti bazë; tiparet personale; bindjet dhe qëllimet; veprimtaria historike; vlerësimi historik

b. paraqitjes të këtij personazhi si hero, si një figurë me një vizion që tejkalon kufijtë kombëtarë, duke mishëruar vlera universale për dinjitetin njerëzor.

I udhëhequr nga ide të mëdha, Llazar Fundo, synon jo vetëm çlirimin e një populli, por edhe përparimin moral e shoqëror të njerëzimit. Ai vlerësohet si filozofi më i madh që ka pasur raca shqiptare.

Gjithashtu, kjo analizë na çon edhe në përfundimin se vepra e znj. Petoshati nuk ka vlerë vetëm letrare, por edhe dokumentare dhe etike, duke u shndërruar në një burim reflektimi për studiuesit, lexuesit dhe opinionin publik. Ajo na kujton rëndësinë e qëndrimit kritik ndaj së kaluarës dhe nevojën për të folur me përgjegjësi për të vërtetat e dhimbshme që i përkasin historisë sonë të përbashkët.

Fjalë kyçe: personazhi historik Llazar Fundo; ligjëratë e drejtë ‘ ligjëratë e zhdrejtë; “ndodhi gjuhësore”.

LLAZAR FUNDO AS A HISTORICAL CHARACTER IN THE NOVEL "RETURN TO VENTOTENE"

Abstract

The writer Laureta Petoshati has made a significant contribution to the literary treatment of a topic with great historical, social, and international value – political internments on the island of Ventotene, through her work "Return to Ventotene," where the historical character Llazar Fundo stands out in a special way. In this presentation, the aim is to analyze this historical figure, having a linguistic perspective, which is realized through:

1. The masterful intertwining of the straightforward discourse with the oblique discourse.

2. The analysis of the fact that "linguistic occurrence" is characterized by a harmony of interaction between the lines of "Pal Leka" and "Llazar Fundo," where the first line serves as a context in which the second line is unraveled.

Specifically, the unraveling of the "Fundo" line is characterized by these features:

- a. the realization of the complete spectrum of elements of a historical character, such as: basic identity; personal traits; beliefs and objectives; actions. historical activity; historical assessment of this character.***
- b. as a hero, as a figure with a vision that transcends national borders, embodying universal values for human dignity. (Guided by great ideas, Llazar Fundo aims not only for the liberation of a people, but also for the moral and social advancement of humanity. He is regarded as the greatest philosopher that the Albanian race has had.) Furthermore, this analysis leads us to the conclusion that the work of Ms. Petoshati holds not only literary value, but also documentary and ethical significance, turning into a source of reflection for scholars, readers, and the public opinion. It reminds us of the importance of a critical stance towards the past and the need to speak responsibly about the painful truths related to our common history.***

Keywords: *the historical character* Llazar Fundo; right discourse; wrong discourse; 'linguistic event'.

Shkrimtarja Laureta Petoshati, ka dhënë një kontritribut të rëndësishëm në trajtimin letrar të një teme me vlera të mëdha historike, shoqërore dhe ndërkombëtare – internimet politike në ishullin Ventotene, përmes veprës së saj "Rikthim në Ventotene.", ku spikat në mënyrë të veçantë personazhi historik Llazar Fundo.

Në këtë kumtesë, synohet analiza e kësaj figure historike, duke pasur një këndvështrim gjuhësor dhe letrar, që realizohet me:

I. Identifikimin e gërshetimit mjeshtëror të ligjëratës së drejtë me ligjëratën e zhdrejtë në kuadër të tekstit letrar.

Në analizën e tekstit letrar, një ndër veçoritë më të dallueshme dhe më të rëndësishme në ndërtimin e strukturës narrative është mënyra se si autorja përdor ligjëratën, në funksion të zbërthimit të karaktereve, situatave dhe marrëdhënieve mes tyre. Një tipar që bie në sy në këtë kontekst është gërshetimi mjeshtëror i ligjëratës së drejtë me atë të zhdrejtë,¹ i cili krijon një dinamizëm të brendshëm në rrëfim dhe rrit shkallën e besueshmërisë së përjetimit emocional të ngjarjeve.

Ligjërata e drejtë, si formë përfaqësimi e fjalëve të personazheve në mënyrë të drejtpërdrejtë, i jep zë të menjëhershëm figurave letrare, duke ruajtur intonacionin, ritmin dhe ngjyrimin emocional të tyre. Nga ana tjetër, ligjërata e zhdrejtë, si mënyrë e ndërmjetme e të folurit, lejon që narratori të filtrojë fjalët e personazhit përmes perspektivës së vet, duke ndikuar në mënyrën si i përjeton ato lexuesi.

Në tekstin që po shqyrtojmë, kjo ndërthurje nuk është e rastësishme, por e ndërtuar me vetëdije artistike për të thelluar kuptimin dhe për të rritur efektin e komunikimit letrar. Ligjërata e drejtë shërben për të

¹ Dako, Niko; Biba, Elona; Jashari, Ali; *Formim Gjuhësor 3*, (Tekst për studentët), Kotti, tetor, 2005, f. 218-224.

(Biba) Çeçe E. *Ndërtimet sintaksore të shqipes përmes shembujve praktikë*, Korçë, 2008, f.101.

përforsuar praninë dhe zërin individual të personazheve, ndërsa ligjëratat e drejta pasqyrojnë pikëpamjen, gjykimin dhe qëndrimin e autorit ndaj tyre. Kjo ndërthurje e dy mënyrave të folurit ndihmon në ndërtimin e një rrëfimi kompleks dhe të shumëdimensionuar, i cili mund të analizohet në thellësi përmes shembujve konkretë që dalin nga rrëfimi i personazheve kryesorë dhe nga situatat narrative ku ata ndodhen.

Si përfundim në lidhje me këtë pikë mund të themi se:

a. romani shfaqet si një ndërthurje të kujdesshme midis dokumentimit historik dhe fuqisë së rrëfimit artistik;

b. kjo strategji kontribuon në ruajtjen e kësaj periudhe të errët të historisë sonë kombëtare në kujtesën kolektive.

II. Analizën e faktit se “ndodhia gjuhësore” karakterizohet nga një harmoni e bashkëveprimit të linjave” Pal Leka” dhe “Llazar Fundo”, ku linja e parë, shërben si kontekst, ku zbërthehet linja e dytë.

1. *Ndodhia gjuhësore* në këtë rast nuk është vetëm një veprim komunikativ, por një strukturë narrative komplekse ku ndërthuren dy linja rrëfimi: ajo e Pal Lekës dhe ajo e Llazar Fundos. Ky bashkëveprim është realizuar në mënyrë të tillë që linja e parë – ajo e Pal Lekës – vepron si një kontekst themelor, një bosht i jashtëm ku zhvillimi i karakterit, ngjarjeve dhe sfondit historik shpaloset në mënyrë kronologjike dhe ideologjike. Në këtë kontekst, rrëfimi i Pal Lekës krijon një kornizë të qartë që përgatit terrenin për të kuptuar dhe zbërthyer në mënyrë më të thelluar linjën e dytë – atë të Llazar Fundos. Linja e Llazar Fundos, është më introspektive, më filozofike dhe shpeshherë e mbështjellë me dilema ideologjike. Ajo nuk mund të kuptohet plotësisht jashtë kontekstit që ndërton linja e parë. Pra, ndërveprimi mes këtyre dy linjave nuk është linear, por dialektik – ku njëra ndriçon tjetrën dhe e bën të mundur një interpretim më të thelluar

të ngjarjeve dhe të qëndrimeve ideologjike që përfaqësojnë personazhet.

Në këtë mënyrë, *ndodhia gjuhësore* bëhet një fushë e ndërveprimit midis narrativës së jashtme (veprimit) dhe asaj të brendshme (reflektimit). Kjo harmoni rrëfimi krijon një shtresim të kuptimësisë në tekstin letrar, duke e shndërruar atë në një strukturë të hapur ndaj leximit analitik dhe interpretativ. Kjo marrëdhënie kontekstuale e Pal Lekës dhe Llazar Fundos lejon që lexuesi të kuptojë më mirë jo vetëm zhvillimet narrative, por edhe prapavijat ideore që autorja dëshiron të vërë në dukje përmes këtyre dy figurave.

Zbërthimi i linjës së Llazar Fundos dhe koherenca tematike

Në roman, linja narrative që ndjek figurën e Llazar Fundos përfaqëson një strukturë të qartë dhe të qëndrueshme të karakterizimit historik e ideor, e cila ruan në mënyrë të vazhdueshme koherencën tematike gjatë gjithë rrëfimit. Kjo linjë nuk është një përshkrim i thjeshtë biografik i një personazhi historik, por një ndërtim artistik² që pasqyron në mënyrë të integruar dhe të harmonizuar të gjitha aspektet përbërëse të identitetit të tij.

Zbërthimi i figurës së Fundos karakterizohet nga disa veçori thelbësore:

(Në funksion të konkretizimit të argumenteve të parashtruara, janë përzgjedhur fragmente vizuale të shkëputura nga vepra. Përmes kësaj qasjeje, synohet të krijohet një marrëdhënie më e drejtpërdrejtë ndërmjet interpretimit teorik dhe materialit burimor. Përzgjedhja e fragmenteve thekson disa elemente kyçe, që mbështesin analizën.)

² (Biba) Çeçe E. Ndërtimet sintaksore të shqipes përmes shembujve praktikë, Korçë, 2008, f.17-30.

Çeliku M., Sintaksë e gjuhës shqipe, (Përbërësit sintaksorë) vështrim i ri teorik, ILAR, Tiranë 2012, f.293-319.

Çeliku M., Sintaksë e gjuhës shqipe, (Përbërësit sintaksorë) vështrim i ri teorik, ILAR, Tiranë 2012, f.134-145.

1. Realizimi i spektrit të plotë të elementeve të një personazhi historik, ku përfshihen:

Fig.nr.1 *Identiteti bazë*: emri, origjina e familjes, lidhjet familjare dhe lidhjet e tij intelektuale.




Fig.nr.2

Tiparet personale –përmes sjelljes individuale faktohet mënyra kritike e të menduarit dhe karakteri impulsiv, që e dallojnë si një figurë unike brenda sfondit historik;




Fig.nr.3

Bindjet dhe qëllimet – orientimi ideologjik i Fundos, përplasjet e tij me linjat zyrtare të kohës, vizioni i tij për lirinë dhe për të ardhmen e shoqërisë.




Fig.nr.4




Fig. nr.5

- Mirë e ka thënë. Unë nuk jam penduar kundër
komunizmi. Më vjen keq për komunistët që nuk po e kuptojnë
akoma që unë nuk kam hequr dorë nga parimet universale të
lirisë, barazisë dhe drejtësisë shoqërore. U kam thënë se
komunizmi i Antonio Gramsci-t është ndryshe nga ai fshataresk
i Stalinit, por gjithsesi komunizmi është një utopi. Është një
gënjeshtert dhe parashikimi i Gjermani, por në fakt
diktatura

Fig.nr.6

Veprimtaria historike – angazhimi konkret politik (raporti me idetë
komuniste dhe më pas kritika ndaj tyre), roli në ndërmarrjet historike.

- Përfaqësoj veten time dhe shqiptarët antifashistë, pa
përfashtim, këtu në ishull, të cilët për arsye të një diktature që u
vendos këtu, patën të njëjtin fat me ju. Shqiptarët që janë këtu,
të nesërmen e tyre e mendojnë në një shtet të lirë, demokratik
dhe pluralist, ku partitë politike të jenë në gjendje të bëhen
bashkë, për të mirën e vendit, në një bllok, sipas një sistemi
shumëshkallësh, me besim të ndërsjellët dhe solidaritet
reciprok. Kështu arrihet vendosja e republikës sonë, kështu
arrihet edhe federata evropiane, ëndrra e shumë njerëzve dhe
aspirata e Altiero-s. Sa për fjalën "tradhtar", një shkencëtar i

Fig.nr.7

- Që në muajt e parë të vitit 1940, i ve shkurt të atij viti, isha në burgun e Barit dhe në fillim të marsit më sollën në Ventotene bashkë me profesorë të tjerë të Liceut Francez të Korçës si Abas Ermenji, Safet Butka, Fasli Frashëri, Selman Riza, Stavro Skendi, Izet Bebeziqi etj. Po ka pasur që kanë ardhur para nesh, antifashistë e familje nacionaliste që ishin ngritur kundër pushtimit. Mbas nesh, në mes të prillit, vjen dhe një grup i madh tjetër me shqiptarë, ku ishte dhe Isuf Luzaj, si antifashist, që kishte kundërshtuar pushtimin e Shqipërisë. U bëmë një dorë e mirë që kishim studiuar në Francë, - tha Zai.

Fig. nr.8

Vlerësimi historik – mënyra se si historia duhet ta trajtojë figurën e tij, si një idealist, si një person që sfidoi, duke paguar “me jetë” për qëndrimet e tij.

- Mua më thirrën në Moskë, “Camarades”, - i tha Zai, duke e thërritur Luigi Longo-n ashtu si i flisnin në Spanjë dhe vazhdoi: - Më thirrën të shkoja në Spanjë, si këshilltar juridik pranë kryeministrit Negrin. Më thanë të merrja me vete të fejuarën time gjermane, Margot, e cila do të shkruante diçka për gazetën. Më thirri vetë Dimitrovi. Kur më sollën letrën në Paris dhe më thanë se është nga Dr. Hediger, e kuptova rëndësinë. Ishte dimër, ftohtë. Ma bëri të rëndësishme situatën. Fliste vetëm për tradhtarë dhe vetëm tradhtarë. Më tha se duhej të nisesha në Spanjë, se atje do të...

2. Të gjitha këto elemente ndërtohen dhe pasqyrohen jo në mënyrë të fragmentuar, por të bashkërenduar, ku secili aspekt përforcon tjetrin, duke krijuar *një vijueshmëri dhe qëndrueshmëri tematike*.

Kjo koherencë tematike është thelbësore për ta kuptuar figurën e Fundos si një nyje qendrore jo vetëm të narrativës letrare, por edhe të diskutimit historik e filozofik që ngre romani.

Në mënyrën si ndërtohet figura e tij, autorja nuk e ndan jetën personale nga ajo ideore. Kjo veçori siguron që çdo pjesë e rrëfimit që lidhet me Fundon të mos jetë thjesht episodike apo dokumentare, por të kontribuojë *në ndërtimin e një vizioni të plotë dhe tematikisht të qëndrueshëm*. Në këtë mënyrë, figura e Llazar Fundos bëhet simbol i konfliktit mes idealit dhe realitetit, mes të menduarit të lirë dhe dhunës ideologjike, mes identitetit personal dhe atij historik.

Koherenca tematike e bën linjën e Fundos jo thjesht një trajektore biografike, por një dritare mbi përplasjen e ideve, mbi sfidën për të ruajtur integritetin në një kohë që kërkonte nënshttrim ideologjik. Ajo është në vetvete një platformë reflektimi mbi lirinë, guximin dhe tragjedinë e atyre që zgjedhin të mendojnë ndryshe.

Ja një shembull që tregon mënyrën se si perceptohetky personazh nga të tjerët (vlerësimi historik):

Ndaj professor Isuf Luzaj, që kishte biseduar me Alessandron, kur kishte pyetur për shokët e Ventotenes...Llazar Fundofilozofi më i madh që ka pasur raca shqiptare...³Kështu, shkrimtarja, na ka dëshmuar se gjuha dhe organizimi i saj veçantë mund të jetë “strehë për të shkuarën dhe urë për të ardhmen”. Ky fakt e bën veprën jo vetëm një akt krijimtarie, por edhe një akt drejtësie historike.

II. Harmonia narrative përmes koherencës tematike dhe kohezionit sintaksor

³ Petoshati Laureta; Rikthim në Ventotene, Tiranë, 2012.F.466

1. Rendi i kapitujve

Rendi i kapitujve në roman përcakton ritmin e rrëfimit dhe mënyrën se si ndërtohet tensioni letrar. Kapitujt janë organizuar në mënyrë që të pasqyrojnë zhvillimin tematik të figurës së Fundos, duke e paraqitur atë nga këndvështrime të ndryshme – historik, ideor, njerëzor.

(Për shembull kalimi nga kapitulli 13 në 14, është një nga rastet ku ka zhvillim të dukshëm tematik rreth Fundos.)

2. Rendi i paragrafëve

Rendi i paragrafëve në një tekst narrativ ndihmon në organizimin logjik të ideve dhe ruan vazhdimësinë e temës qendrore. Në romanin e Petoshatit, paragrafët ndërtohen në mënyrë të tillë që zbulojnë gradualisht konfliktin e brendshëm të personazheve.

Lidhja midis paragrafëve i shërben thellimit të karakterit të Fundos.

3. Bashkëlidhja e trajtave mënyrore-kohore të foljeve

*Kohezioni në tekst përforcohet edhe përmes përdorimit në harmoni të mënyrave dhe kohëve të foljeve.*⁴ Autorja përdor një vijimësi të qëndrueshme të kohëve narrative (e kryera e thjeshtë, dhe e tashmja e mënyrës dëftore) për të ndërtuar një rrëfim që nuk humbet në lëvizje të paqarta kohore, por ruan një strukturë të lexueshme e të kuptueshme.

Pra, lëvizja kohore është në funksion të ruajtjes së kohezionit.

4. Gjymtyrëzimi aktual i fjalive

Ndërtimi sintaksor i fjalive ndikon drejtpërdrejt në mënyrën se si perceptohet mesazhi tematik. Gjymtyrëzimi i rregullt (temë, remë) siguron qartësi dhe ruan fokusin tematik.⁵p.sh “*Zai i veshur me një këmishë bojëqielli të çelur, të cilës i kishte shpërvjelë mëngët deri në bërryla, gjithë gazmend (tema) lëshoi një thirrje të fortë (rema)...*”⁶

⁴ Dako, Niko; Biba, Elona; Jashari, Ali; Formim Gjuhësor 3, (Tekst për studentët), Kotti, tetor, 2005, f.146-15.

(Biba) Çeçe E.Ndërtimet sintaksore të shqipes përmes shembujve praktikë, Korçë, 2008, f.68-75.

⁵ Dako, Niko; Biba, Elona; Jashari, Ali; Formim Gjuhësor 3, (Tekst për studentët), Kotti, tetor, 2005, f.100-105.

⁶Laureta Petoshati; Rikthim në Ventotene, Tiranë, 2012, f.156.

Në mbyllje të kësaj analize mund të themi se përmes dialogut, *në kuadër të ligjaratës së drejtë, në kontekste e situata personazhi historik, Llazar Fundo, paraqitet si një figurë me një vizion që tejkalon kufijtë kombëtarë, duke mishëruar vlera universale për dinjitetin njerëzor.

I udhëhequr nga ide të mëdha, Llazar Fundo, synon jo vetëm çlirimin e popullit, por edhe përparimin moral e shoqëror të njerëzimit.

Gjithashtu, analiza vërteton se vepra e znj. Petoshati nuk ka vlerë vetëm letrare, gjuhësore, por edhe dokumentare dhe etike, duke u shndërruar në një burim reflektimi për studiuesit, lexuesit. **Sepse kujton rëndësinë e qëndrimit kritik ndaj së kaluarës dhe nevojën për të folur me përgjegjësi për të vërtetat e dhimbshme që i përkasin historisë sonë të përbashkët.**

BIBLIOGRAFIA

(Biba) Çeçe Elona, Ndërtimet sintaksore të shqipes përmes shembujve praktikë, Korçë, 2008.

Berisha Nikë Anton, Teksti poetik, Rilindja, 2023

Dako, Niko; Biba, Elona; Jashari, Ali; Formim Gjuhësor 3, (Tekst për studentët), Kotti, tetor, 2005.

Petoshati Laureta; Rikthim në Ventotene, Tiranë, 2012.

Topalli Tefë, Me gjuhën dhe stilin e poezisë, Tiranë, 2023.

NGA USTIKA NË VENTOTENE: ZAI FUNDO DHE PETRO MARKO NË FILTRAT E HISTORISË (TË PËRBASHKËTA DHE PARALELE)

Prof. as. dr. Eris RUSI

*Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë
Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë
Universiteti “Fan S. Noli”*

Abstrakt

Ky artikull synon të analizojë figurën e intelektualit të angazhuar shqiptar përmes një leximi krahasues të përvojave të veçanta, por paralele të Petro Markos dhe Zai Fundos gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore. Të internuar nga regjimi fashist italian në vitet 1941–1943, përkatësisht në Ustikë dhe Ventotene, këta dy figura përfaqësojnë dy trajektore të ndryshme – shkrimtari dhe publicisti – që ndajnë si qëndrim të përbashkët nevojën për të mos heshtur përballë padrejtësisë. Pa qenë kurrë të rreshtuar me pushtetin, por gjithnjë në anën e fjalës së lirë dhe ndërgjegjes morale, ata mishërojnë atë që Antonio Gramsci e quan “intelektuali organik”: figura që e vendos dijen dhe krijimtarinë në shërbim të një ideali emancipues, të përballur me format konkrete të represionit historik.

Figura e Fundos, e rizbuluar në përshkrimet e bashkëvuajtësve të tij në Ventotene, shfaqet si një intelektual i përkushtuar ndaj reflektimit filozofik, formimit autodidakt dhe emancipimit individual, ndërsa Marko e kthen përvojën e tij të internimit në një akt letrar që ndërthur dokumentin historik me ndjeshmërinë estetike, faktin objektiv me zërin subjektiv të dëshmitarit. Artikulli nënvizon se, për të dy, fjala nuk është vetëm mjet shprehjeje, por formë qëndrese, vendim etik dhe akt ndërgjegjeje.

Kjo pranëvënie nuk ka si synim barazimin formal të veprës së tyre, por ndriçimin e një përbashkësie të thellë në raport me etikën e fjalës, qëndrimin kundër tiranisë dhe refuzimin e kompromisit me harresën. Përmes leximit krahasues, artikulli kontribuon në rivlerësimin e rolit të intelektualit në historinë shqiptare, si zë kritik dhe udhërrëfyes në kohë të errëta.

Fjalë çelës: *Mendimi kritik; kujtesa kulturore; emancipimi intelektual; qëndrim moral; letërsi.*

FROM USTICA TO VENTOTENE: ZAI FUNDO AND PETRO MARKO THROUGH THE FILTERS OF HISTORY – SHARED AND PARALLEL PATHS –

Abstract

This article aims to explore the figure of the engaged Albanian intellectual through a comparative reading of the distinct yet parallel experiences of Petro Marko and Zai Fundo during the years of the Second World War. Interned by the Italian fascist regime between 1941 and 1943—Marko in Ustica and Fundo in Ventotene—these two figures represent divergent trajectories, one as a writer and the other as a publicist, yet they share a common stance: the necessity not to remain silent in the face of injustice. Without ever aligning with power, and always positioned on the side of free speech and moral conscience, they embody what Antonio Gramsci defines as the “organic intellectual”: a figure who places knowledge and creativity at the service of an emancipatory ideal, confronted with the concrete forms of historical repression.

Fundo’s image, rediscovered through the testimonies of his fellow internees in Ventotene, emerges as that of a thinker devoted to philosophical reflection, autodidactic cultivation, and individual emancipation. Marko, on the other hand, transforms his internment experience into a literary act that weaves together historical documentation with aesthetic sensitivity, and objective fact with the subjective voice of the witness. The article argues that for both men, language is not merely a tool for expression, but a form of resistance, an ethical stance, and a conscious act of presence.

The aim of this juxtaposition is not to equalize their literary output, but to illuminate their shared commitment to the ethics of the word, their opposition to tyranny, and their refusal to compromise with oblivion. Through this comparative approach, the article contributes to a re-evaluation of the intellectual’s role in Albanian history—as a critical voice and moral guide in times of darkness.

Keywords:

Critical thought; cultural memory; intellectual emancipation; moral stance; literature.

Hyrje

Përfytyroni një njeri që është buzë greminës: me duart në xhepa, sfidon fatin e panjohur, aty ku fryjnë erërat kobzeza të kohës. Mbushet me ajër, dhe në atë shtrëngim të shkurtër të syve, futet një qiell i tërë: liri, mendime, ndjesi që nuk kanë të bëjnë me burgosjen, as me internimin, as me fasadat e mëdha të ideologjive që humbasin shkëlqimin në sytë e atyre që dinë të depërtojnë në brendësi.

Në të njëjtën periudhë kohore, nga viti 1941 deri më 1943, dy intelektualë shqiptarë Zai Fundo dhe Petro Marko, ndodheshin në dy burgje të ndryshme italiane: në Ventotene dhe Ustikë. I njëjti fat, të njëjtat duar në xhepa, sytë në të njëjtin drejtim, kah lartësive. Marko do të kthehej e do të bëhej një nga shkrimtarët më të rëndësishëm të letërsisë shqipe. Fundo do të kthehej dhe do ekzekutohej në pjekurinë e moshës.

I mbushur me ëndrrat dhe zhgënjimet e tij, në shkrimin Alberto Xhakometi-t, bashkëvuajtës me Fundon në ishullin e Ventotene-s sjell një portretizim të veçantë të këtij intelektual:

“Duhet ta shohësh në orët e para të mëngjesit, kur studion jashtë, në natyrë – është mënyra e tij normale për të studiuar. Flokët – ato pak që i kanë mbetur – të çrregullt nga era, biondë, por në majat më të gjata aq të zbehur sa duken si të bardhë, me kokën lart – një profil pothuajse romak –, ecën me hapa të gjatë dhe gjestikulon me dorë teksa shqipton: ‘Akili, Akili i këmbëshpejti, që vrapon buzë detit’.¹”

Kështu na paraqitet Fundo si një figurë që jeton në lëvizje, në mendim, në ritëm. E çdo mëngjes i tij është një akt rezistence i heshtur ndaj shkatërrimit shpirtëror që sjell internimi.

Mënyra e tij e të studiuarit është sa metodike, aq edhe poetike: “Ai kopjon fjalën ose fjalinë që e tërheq në copëza letre, të cilat i mbushin xhepat e tij: i lexon, i kthen prapë në vend, i nxjerr përsëri, derisa fjalia ose fjala të jetë ngulitur përfundimisht në tru.”² Në këtë

¹ Cfr. Alberto Jacometti, Ventotene, Mondadori, Milano 1946

² Po aty

mënyrë mësoi disa gjuhë. Me këtë mënyrë i rezistoi harresës, rraskapitjes, kohës.

Dhe për këtë, Zai Fundo përngjan si një zë paralel me zërin e shkrimtarit Petro Marko. I njëjti qiell në sy, i njëjti ajër në mushkëri. I njëjti ideal, që as internimi nuk mundi ta ndalojë.

Në një vështrim të parë, mund të ngjajë e pabarabartë të vendosësh pranë njëri-tjetrit këta dy emra. Petro Marko është një personalitet i njohur i letrave shqipe, me një korpus të gjerë veprash që përfshin romane, publicistikë dhe dëshmi të jetës së burgut, ndërsa Fundo, i lënë në heshtje për një periudhë gati pesëdhjetë vjeçare kishte tragjike jetën e prerë në mes: u vra në moshën 45-vjeçare pa arritur të shpалosë botëkuptimin e plotë krijues të tij. Por kjo pranëvënie synon jo të barazojë, por të ndriçojë një të përbashkët themelore në përmasën e qëndrimit, të idealit dhe të ndërgjegjes.

Petro Marko dhe Zai Fundo janë dy prej përfaqësuesve më të qartë të asaj që Antonio Gramsci e cilëson si “intelektuali organik”³ — ai që nuk qëndron mbi shoqërinë, por angazhohet brenda saj, që nuk përkrah kurrë me indiferencë pushtetin, por kërkon të ndryshojë realitetin përmes fjalës dhe aktit.

Të dy u përballën me internimin dhe persekutimin në Itali: Marko në Ustikë (1941–1943), Fundo në Ventotene (1941–1943). Kjo përvojë e përbashkët në burgjet politike, në mes të një Evrope në krizë, nuk ishte vetëm ndëshkim, por një hapësirë reflektimi dhe rezistence. Në kujtimet e Altiero Spinellit, Fundo përshkruhet si “më i ndrituri ndër intelektualët shqiptarë në Ventotene”⁴, i aftë të zhvillonte biseda të thella me Spinellin, ndërsa lexonte Platonin në origjinal dhe citonte Homerin në mëngjes, vetëm për të mos harruar se liria fillon te mendimi.

Petro Marko, në anën tjetër, mbeti në jetë për të dëshmuar atë që Fundo nuk arriti ta shkruajë: se internimi nuk shkatërron dinjitetin, por mund

³ Antonio Gramsci, *Quaderni del carcere*, a cura di Valentino Gerratana, Torino: Einaudi, 1975, vol. 1, quaderno 12

⁴ Altiero Spinelli, *Come ho tentato di diventare saggio*, Il Mulino, Bologna 1999

të thellojë kuptimin e fjalës. Në *Nata e Ustikës* ai shkruan: “Një natë më tepër në burg ishte një ditë më tepër për të mos u nënshtruar.”⁵ Është një frazë që mund të përshkruante me të njëjtën forcë edhe përvojën e Fundos.

Fundo e refuzoi hapur stalinizmin, u përjashtua nga Kominterni, e humbi mbështetjen politike, por e ruajti integritetin intelektual. Ai shkruante se “emancipimi nuk mund të vijë përmes shtypjes së një njeriu tjetër” — një deklaratë e qartë kundër çdo lloj diktature. Ky pozicion e bën Fundon një nga figurat më të sinqerta të së majtës demokratike shqiptare, një zë i vetmuar por i qartë, i ndershëm deri në fund.

Ndërsa Petro Marko, edhe pse pati një jetë më të gjatë, nuk u dorëzua asnjëherë brenda mekanizmave të regjimit komunist. Ai jetoj si shkrimtar i dyshuar, i përjashtuar, shpesh i detyruar me forcë të heshtë. Në kujtimet e tij (*Retë dhe gurët*), ai rrëfen: “Në çdo sistem, unë isha një element i padëshiruar, jo sepse nuk doja vendin tim, por sepse doja të them të vërtetën.”⁶

Prandaj, kjo pranëvënie është e justifikuar. Ajo bazohet në përmasën e përbashkët që të dy mishërojnë: intelektualë të pakompromis, që nuk pranuan të heshtnin për të shpëtuar veten, që e panë dënimin si një çmim për bindjet intelektuale, ndaj e pranuan, pa hezitim.

Intelektuali në kohë përplasjeje

Në një shekull të trazuar nga luftërat, totalitarizmat dhe rënia e idealeve, figura e intelektualit mbetet një udhëkryq moral mes fjalës dhe veprimit, mes bindjes personale dhe presionit historik. Intelektuali nuk është vetëm bartës i dijes, por dëshmitar i së vërtetës, shpeshherë edhe kur ajo është e padurueshme për kohën në të cilën jeton. Në këtë kontekst, Petro Marko dhe Zai Fundo përfaqësojnë dy forma të ndryshme, por thellësisht të ndërthurura të këtij arketipi: shkrimtari dhe publicisti, po aq të përfshirë në letërsi sa edhe në histori, të dy të

⁵ Petro Marko, *Nata e Ustikës*, ribotim Albas, Tiranë 2012

⁶ Petro Marko, *Intervistë me vetveten (Retë dhe gurët)*, Tiranë: OMSCA, 2000

përndjekur, të internuar, të anatemuar, por kurrë të nëpërkëmbur shpirtërisht.

Të lindur në Shqipërinë e fillimshëkullit XX, në një kohë kur kombi shqiptar kërkonte identitetin e vet përmes përplasjes me Fuqitë e Mëdha, duke kaluar nga Pavarësia në Revolucionin e Qershorit, Monarkinë e Zogut e më tej regjimin monist, Marko dhe Fundo përfaqësojnë figura që u rreshtuan në mbrojtje të të shtypurve, të të përjashtuarve, të atyre që historia zyrtare nuk i sheh.

Ustika dhe Ventotene, dy ishuj të bukur dhe të dhimbshëm të burgosjes politike në Itali, janë më shumë se thjesht vende gjeografike. Ato mund të konsiderohen si simbol i përbashkët i fatit të dy intelektualëve që nuk u trembën as nga fashizmi, as nga stalinizmi, dhe as nga harresa. Për të dy, burgu nuk ishte thjesht një vend ndëshkimi, por një hapësirë ku mendimi thellohej dhe qëndrimi moral ngrihej mbi dhunën e kohës.

Petro Marko u burgos dhe u internua nga regjimi fashist italian pas kthimit nga Spanja, ku kishte luftuar me Brigadat Ndërkombëtare kundër Frankos. Ai kishte zgjedhur të mbante armë në dorë për të mbrojtur një ideal që e tejkalonte kufirin e kombit: lirinë si koncept universal.

Zai Fundo, nga ana tjetër, në Ventotene, nuk ishte thjesht një i burgosur politik, por një zë që shkonte përtej nacionalizmit të ngushtë. Ai nuk u kthye më në Partinë Komuniste, ndonëse në Shqipëri do të kishte qenë i mirëpritur si hero – sepse nuk pranonte më asnjë formë totalitarizmi, as të djathtë, as të majtë. Ai e konceptonte lirinë si bindje të brendshme, jo si privilegj të marrë në shkëmbim të heshtjes. Pikërisht kjo e çoi drejt vdekjes mizore, në shtator të vitit 1944.

Nëse për shumë figura politike dhe kulturore fjala shërben si mjet, për Petro Markon dhe Zai Fundon fjala është akt. Është vendim, është sfidë, është drejtim moral. Letërsia e Markos dhe publicistika e Fundos nuk janë vetëm forma artistike apo retorike, por dëshmi të një ekzistence që kërkon lirinë si të drejtë ontologjike, jo si privilegj politik. Të dy, në mënyra të ndryshme, ndërtuan me fjalën një strehë rezistence — një vetëdije që sfidon dhunën e historisë.

Në këtë mënyrë, të dy hyjnë në traditën më të ndritur të intelektualëve evropianë të shekullit XX, që artikuluan vetëdijen e tyre politike, njerëzore dhe kulturore jo për të prodhuar iluzione, por për të zbuluar të vërtetën e dhimbshme dhe për t'i dhënë asaj një zë të sinqertë.

4. Intelektuali si mërgimtar i së vërtetës

Nëse ka një emërues të përbashkët që bashkon Petro Markon dhe Zai Fundon përtej fjalës së shkruar, është vetmia e vetëdijshme, e zgjedhur jo si izolim shpirtëror, por si refuzim i kompromisit me çdo formë të pushtetit që i mohon njeriut të drejtën për të menduar lirshëm. Të dy janë, në thelb, mërgimtarë të së vërtetës, njerëz që braktisin bindjet e rehatshme të kohës, për të qëndruar në anën e drejtësisë, edhe kur ajo është e padukshme ose e pamundur.

Petro Marko, pas kthimit nga internimi dhe burgosja në diktaturën komuniste, mbeti një shkrimtar i censuruar, i lënë shpesh në harresë, ndonëse i lexuar fshehurazi. Ai nuk ishte “i besuar” për institucionet e artit zyrtar, sepse refuzonte të rreshtohej. Në romanin *Një emër në katër rrugë* ai guxoi të shkruante për dramën e njeriut që kërkon dinjitetin në një sistem që i kërkon bindje. Ai ishte një “i huaj” në një letërsi të rreshtuar, por kurrë i huaj ndaj dhimbjes së popullit të tij.

Zai Fundo, nga ana tjetër, u bë i huaj për të gjithë: i përjashtuar nga Kominterni, i refuzuar nga partizanët, i tradhtuar nga idealet që kishte ndjekur me pasion në rini. Ai nuk u kthye në Shqipëri për të marrë pushtet, por për të ndihmuar në çlirimin e vendit nga nazistët, duke shpresuar se kjo do të sillte një shoqëri të lirë. Në vend të kësaj, përfundoi i torturuar dhe i pushkatuar si “trockist” nga të njëjtët që ai kishte ndihmuar. Figura e tij mbetet një simbol tragjik i atij intelektual që zgjedh të mos i përkasë askujt, përveç së vërtetës.

Për Petro Markon, gjithçka që nuk përkthehej në liri ishte e pavlerë. Në një nga intervistat e fundit ai pohon: *"Edhe në çastet më të vështira të jetës, kam ëndërruar lirinë, të jem i lirë si zogjtë nëpër pyje."*⁷ Ëndrra

⁷ <https://exlibris.al/namik-dokle-petro-marko-simboli-i-lirise-edhe-kur-ajo-mungonte>

e tij nuk ishte një luks, por një domosdoshmëri njerëzore. Edhe në shkrimet e tij më të errëta, është kjo ëndërr që e mban të gjallë frymën. Ndaj, intelektual i vërtetë, siç e mishërojnë Marko dhe Fundo, nuk është ai që e gjen vendin e tij në institucionet e pushtetit, por ai që e sfidon vetminë si çmim të bindjes së thellë. Të dy janë të vetmuar, por kurrë të heshtur. Në kohë urrejtjeje, ata nuk urrejnë; në kohë gënjeshtre, ata shkruajnë të vërtetën; në kohë të verbër, ata mbajnë sytë hapur. Në mbyllje, Petro Marko dhe Zai Fundo janë dy figura që bartin në vete një mësim të pazëvendësueshëm për brezat që vijnë: se kultura nuk është dekor, por mjet rezistence, se shkrimtari dhe intelektual nuk janë ornamente të shoqërisë, por rrënjët që mbajnë në këmbë vetëdijen e saj. Marko e jetoj letërsinë jo si një mjet për ta kuptuar thellë vuajtjen dhe dinjitetin njerëzor. Fundo, nga ana tjetër, është një nga figurat e neglizhuara dhe të lëna në hije në kujtesën kombëtare. Dhe pikërisht kjo harresë deri dje, sot e bën më të domosdoshme kthimin te ai, si një dëshmitar i brendshëm, si një “Kasandër” moderne që paralajmëroi katastrofën e ideologjive të dhunshme duke qëndruar besnik parimeve themelore të njeriut të lirë. Petro Marko shkruante se edhe në çastin e fundit kishte ëndërruar lirinë. Zai Fundo u vra sepse nuk pranoi ta ndërronte atë ëndërr me asgjë në botë.

Bibliografia:

1. Alberto Jacometti, *Ventotene*, Milano: Mondadori, 1946.
2. Antonio Gramsci, *Quaderni del carcere*, a cura di Valentino Gerratana, Torino: Einaudi, 1975, vol. 1, quaderno 12.
3. Altiero Spinelli, *Come ho tentato di diventare saggio*, Bologna: Il Mulino, 1999.
4. Petro Marko, *Nata e Ustikës*, ribotim, Tiranë: Albas, 2012.
5. Petro Marko, *Intervistë me vetveten (Retë dhe gurët)*, Tiranë: OMSCA, 2000.
6. Petro Marko, *Nëpër udhët e ferrit*, përgatitur për botim nga Arben Puto, Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, 1983.
7. Petro Marko, *Dritë mbi Shqipëri: intervista dhe reflektime*, përmbledhje nga Dashnor Kaloçi, Tiranë: Botimet “TOENA”, 2015.
8. Claude Lefort, *La démocratie à l'épreuve*, Paris: Gallimard, 1990.

9. Primo Levi, *Se questo è un uomo*, Torino: Einaudi, 1958.
10. Ismail Kadare, *Ftesë në studio*, Tiranë: Onufri, 2005.
11. <https://exlibris.al/namik-dokle-petro-marko-simboli-i-lirise-edhe-kur-ajo-mungonte>

PERSONALITETI I LLAZAR FUNDOS NË VLERËSIMIN E INTELEKTUALËVE TË KOHËS

Viola DOLANI

*Departamenti i Shkencave Sociale
Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane
Universiteti "Fan S. Noli"*

Dr. Denisa TITILI

*Departamenti i Shkencave Sociale
Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane
Universiteti "Fan S. Noli"*

Abstrakt

Llazar Fundo konsiderohet si një nga figurat më të spikatura, i cili falë formimit me vlerat perëndimore, u përpoq të jepte kontributin e tij në krijimin e një shtetti të konsoliduar shqiptar. Pas rrëzimit të qeverisë Noli, Fundo, me rekomandimin e tij, mërgoi në Bashkimin Sovjetik, për të vazhduar studimet. Gjatë këtyre viteve të gjatë mërgimit 1924-1939, Fundo dha një kontribut të madh duke publikuar, artikuj për gazetën "Çlirimi Nacional" të cilat kishin në qendër të tyre identifikimin e problematikave që po kalonte shoqëria shqiptare, por njëkohësisht edhe identifikimin e vlerave dhe mundësive që kombi shqiptar kishte për t'i kaluar me sukses. Por angazhimi i tij, vënia në dukje e problematikave por në të njëjtën kohë edhe zgjidhja e shumë prej tyre, nuk mbeti vetë brenda shqipërisë dhe shqipëtarëve, sepse ai i dha zë ndërkombëtar çështjes shqiptare dhe bë një prej bashkëpunëtorëve kryesore të periodikut "La Fédération Balkanique", që botohej në Vjena në disa gjuhë, në vitet 1920-1930. Qëllimi i këtij kërkimi është të nxjerrë në pah vlerat njerëzore, intelektuale, formimin e përgjithëm të Llazar Fundos dhe mbi të gjitha dëshirën dhe përpjekjet konkrete që ëndrra e vet e emancipimit proletar të vinte si rrjedhojë e një praktike lirie dhe jo e një imponimi të egër, burokratik, sic e kishte parë vetë te praktikojë në Rusi. Këto vlera të tij do të identifikohen, referuar shkrimeve që shumë prej miqve të tij i kanë publikuar në shtypin e kohës. Fundo ishte një intelektual i vlerësuar jo vetëm nga intelektualët shqiptarë, por aftësitë e tij shumëdimensionale u vunë re dhe u vlerësuan edhe nga intelektualë evropianë, por edhe më gjerë.

Fjalë kyce: traktati i Ventotenes, europarlamentar socialist, antifashist, vlera intelektuale dhe njerëzore etj.

THE PERSONALITY OF LLAZAR FUNDO IN THE ASSESSMENT OF THE INTELLECTUALS OF THE TIME

Abstract

Llazar Fundo is considered one of the most prominent figures, who, thanks to his formation with Western values, tried to contribute to the creation of a consolidated Albanian state. After the overthrow of the Noli government, Fundo, on Nolis recommendation emigrated to the Soviet Union, to continue his studies. During these long years of exile 1924-1939, Fundo made a great contribution by publishing articles for the newspaper "Çlirimi Nacional" which focused on identifying the problems that Albanian society was going through, but at the same time also identifying the values and opportunities that the Albanian nation had to overcome successfully. His commitment was focused on highlighting the problems, but at the same time solving many of them. This action did not remain only within Albania and Albanians, because he gave an international voice to the national issue, and became one of the main collaborators of the periodical "La Fédération Balkanique", which was published in Vienna in several languages, in the years 1920-1930. The purpose of this research is to highlight the human, intellectual values, the general formation of Llazar Fundo, and above all his desire and concrete efforts for realising his dream, of proletarian emancipation, which would come as a result of practiced freedom and not of a wild, bureaucratic imposition, as he had himself seen practiced in Russia. His values will be identified referring to the writings that many of his friends have published in the press of the time. Fundo was an intellectual appreciated not only by Albanian intellectuals; his multidimensional abilities were also noticed and appreciated by European intellectuals and beyond.

Keywords: Treaty of Ventotene, Socialist MEP, anti-fascist, intellectual and human values, etc.

“Fundo – shqiptar. Duhet ta shihni kur në orët e para të mëngjesit studion jashtë - kjo është mënyra e tij e zakonshme e studimit. Flokët, a më mirë ç’ka mbetur, shpupurisur nga era, të verdha – por në pjeset më të gjata, aq të çngjyrosura sa duken të bardha, koka lart – një profil gati romak «Akil këmbëshpejti që ecën gjatë bregut të detit». Njohës i madh i Homerit dhe Platonit, veç të tjerash. Mënyra e tij e studimit është shumë e çuditshme : shkruan fjalën ose fjalinë që i intereson mbi copa letre me të cilat mbush xhepat: i rilexon, i rifut në xhep, i nxjerr jashtë sërish, derisa fjalja ose fjala shtypet në mënyrë të pafshishme në mendjen e tij. Kështu ka mësuar me themel disa gjuhë. Ish-komunist, ka bredhur mbarë Europën. Ka qenë në Rusi, ku antikonformizmi i tij e bëri të dyshimtë: shpëtoi nga vala e spastrimit që përfshiu gati të tërë gardën e vjetër leniniane dhe u kthye në Shqipëri tamam në kohë për të rënë nën kthetrat e zagarëve musolinianë. Është një nga dy shqiptarët për të cilët nuk ka patur amnisti. I ndërthur studimet e tij të dashura të greqishtes me ekonomistët liberalë anglezë.”

Kështu e kujton miku i tij i burgut, socialisti Alberto Jacometti, një kujtim për të cilin mund të themi që mbetet nga më të ndjerët, me të bukurit dhe më të detajuarit, një kujtim në të cilin shfaqin cilësitë intelektuale, kulturore dhe njerëzore të Fundos.

“Mes të internuarve ndodhet edhe një shqiptar, Lazar Fundo, që ka studiuar në Paris, në Sorbonë dhe ka bredhur mbare Evropën e ka shkuar në Moskë. Pasi u shkëput nga Partia Komuniste, ju afrua Partise Socialiste. Bujar, i hapur, me shumë kulturë, me shpirt djaloshar : bëhet shpejt mik i Pertinit. Takohen edhe një herë, për herë të fundit, në Romë, në gushtin e vitit 1943. Pertini i lutet që të rrijë, por Fundo deshiron të kthehet në Shqipëri, të luftojë me njerëzit e vet. Pasi mbaroi lufta dhe u krijua republika popullore, Fundo u burgos dhe meqenëse refuzonte të hidhte poshtë ideologjinë socialiste, u vra barbarisht.” (Marrë nga: Sandro Pertini, Sei condanne due evasioni, a cura di Vico Faggi, Mondadori, Milano, 1978, fq. 331)

Kështu e kujton presidenti i ndjerë i Republikës Italiane, Sandro Pertini, Lazar Fundon, të internuar bashkë me të nga regjimi fashist në

ishullin italian të Ventotenes, midis Romës dhe Napolit. Shumë italianë e kanë njohur dhe e mbajnë mend Pertinin jo vetëm si njeri thellësisht të ndershtëm, me koherencë solide politike dhe morale, por edhe si njeri me karakter të vështirë, serioz e të ashpër, një njeri që vështirë se quante “mik” një të huaj. Kjo do të thotë që arriti të pranonte Fundon mes miqve të vet sepse ia njihte mirë cilësitë njerëzore, kulturore dhe politike, e kishte konsideruar të denjë për vlerësimin dhe miqësinë e tij.

Në shtypin italian të kohës, një i internuar në Ventotene shkruante: “Mes shqiptarëve shquhej Fundo, një intelektual që kish qenë anëtar drejtues i Partisë Komuniste të vendit të vet, dhe që më pas kishte kaluar në opozitë. Jetonte tërësisht i izoluar, i zhytur në studimin e greqishtes, sikur të kërkonte prej Homerit miqësinë që nuk gjente mes bashkëkohësve të vet. Me rënien e fashizmit, u kthye në atdhe për të luftuar kundër gjermanëve. Ish-shokët e tij i përgatitën një fund të tmerrshëm, duke treguar edhe njëherë që, përsa i përket mizorisë, komunizmi dhe nazizmi, nuk kanë ç’t’i kenë zili njëri tjetrit!” (Giorgio Braccialarghe: “Nelle spire di urlavento, il confino di Ventotene”, Club degli autori, Firenze, 1970, fq. 67).

Eshte për tu theksuar gjithashtu një dëshmi veçanërisht e rëndësishme dhe me peshë, si per autorin e saj Alterio Spinelli, edhe per refleksionet dhe raportet e tij me Lazar Fundon lidhur me veprimtarinë e këtij të fundit në Ventotene, rëndësine që mund të ketë mbi realitetin politik, social dhe kulturor të Shqipërisë sot. Mbas lufte, Spinelli ishte një europarlamentar socialist.

Ja çfarë shkruan Spinelli:

“E reja e parë ishte ardhja e rreth 50 shqiptarëve, nga të cilët dhjetë ishin intelektualë që kishin studiuar në universitetet më të mira të Europës, flisnin tre-katër gjuhë përveç gjuhës së tyre. Ishin arrestuar për tentativë të organizimit të rezistencës kombëtare. Këta krijuan marrëdhënie të mira me të burgosurit italianë, sipas preferencave politike, kush me komunistët, kush me xhelistët (giellisti), dhe njëri prej tyre, Lazar Fundo, me mua. E ndjej për detyrë të flas këtu për

Fundon pasi edhe pse ai në fund u shkëput tërësisht prej meje, kemi qenë miq për disa vite ndaj dhe do doja ketu te ndihmoja, që kujtimi i tij të mos zhduket tërësisht.

Ishte personazhi më me influence mes gjithë shqiptarëve, pasi kishte një përvojë të gjatë dhe të ndërlikuar politike, gje që u mungonte të tjerëve, të cilët ishin shtyrë kohët e fundit në politikë thjesht nga urrejtja për pushtuesit fashistë.

Fundo ishte bërë komunist në Paris, gjatë studimeve universitare. Duke qene se besimit politik i shtohet intelijenca dhe njohja e jo pak gjuhëve, angazhimi e tij politik shkonte përtej Shqipërisë, dhe kur Dimitrovi ishte arrestuar pas djegies së Rajhshtagut, Fundo ndodhej në Berlin si një prej bashkëpunëtorëve të tij. Pasi i shpëtoi arrestit, ishte kthyer në Moskë ku punonte te Internacionalja. Kur filloi epoka e spastrimeve të mëdha, ai, komunist besnik, por i edukuar në atmosferën kulturore të lirë të vendeve demokratike dhe intelektualisht tip kurioz, kishte frekuentuar jo pak prej kundërshtarëve të Stalinit. Meqenëse kish pasur njëfarë simpatie te fshehur për ta, ju nënshtrua hetimeve të stërgjatura e të lodhshme nga ana e një komisioni të Kominternit.

Në Ventotene u afrua natyrshëm me ish-komunistët, xhelistët dhe socialistët me të cilët fliste shpeshherë mbi degjenerimin e regjimit të Stalinit. Ose bënte shëtitje, me trupin drejt, i pashëm, me flokët e verdha që ja merte era, duke përsëritur me zë të ultë fjalët e Platonit, të cilin ishte duke e lexuar greqisht. Kerkonte te të urtët e lashtë qetësinë shpirtërore që ia kish hequr dështimi i përvojës së tij komuniste dhe që nuk e gjente dot gjetkë.

8 shtator, bërthama e fundit e të internuarve të Ventotenes e paçliruar nga Badoglio, Lazar Fundo mbërriti në bregun e Puglias, u hodh në Shqipëri, u paraqit para partizanëve komunistë dhe u deklaroi se kish ardhur të luftonte me ta, u vu prej tyre me shpatulla pas muri dhe u pushkatua. Mund të ishte pak a shumë 40 vjeç. Shpresoj që veç meje, të ketë ndonjë shqiptar nëpër botë që ende e mban mend.” (Ekstrakt “Come ho tentato di diventare saggio”, d’Altiero Spinelli, éd. Il Mulino, Bologne, 1984 et 1987, Nouvelle édition 1988, page 313).

Një miqësi tjetër e krijuar në Ventotene ishte edhe ajo mes Llazar Fundos dhe Ernesto Rossit. Në intervistën e dhënë prej këtij të fundit më 9 nëntor 1966 në Romë, në të cilën Rossi pohon: “... ajo që më interesante më shumë ishte lëvizja federaliste në të cilën ishim mjaft të bashkuar dhe pjesë e saj ishin Colorni, Spinelli, Fundo dhe një grup i vogël prej nja dhjetë vetësh.”

Stavro Skendi ishte shqiptari tjetër mik i Spinellit dhe Rossit në Ventotene.

Vetë Rossi, në një letër dërguar nga Roma më 23 korrik 1946 Stavro Skendit, e kujton Fundon kështu:

“Mora vesh me dhimbje të madhe vdekjen e Fundos. Ishte njeri bujar, inteligjent, që mund të kish dhënë një kontribut të shquar në rindërtimin e vendit të vet, poqese bota nuk do shkonte drejt greminës, siç po bën tani” (Ekstrakt nga “Ernesto Rossi, Epistolario, 1943-1967, dal Partito d’Azione al Centro Sinistra”, par Mimmo Franzinelli, éd. Laterza, Rome – Bari, janvier 2007, page 64)

Riccardo Bauerit, një tjetër antifashist, edhe ai ish-i internuar në Ventotene, shprehet ne kete menyre mbi mikun shqiptar Llazar Fundo:

“Pata atëherë një marrëdhënie simpatike familjare me një gazetar shqiptar, Llazar Fundon, i cili pas një përvoje të gjatë në vendin e vet dhe në Rusi, e kishte braktisur Partinë Komuniste pa hequr dorë megjithatë nga besimi i tij, pasi donte që ëndrra e vet e emancipimit proletar të vinte si rrjedhojë e një praktike lirie dhe jo e nje imponimi të egër, burokratik, siç e kishte parë vetë të praktikohej në Rusi.

I pajisur me inteligjencë të madhe, kishte një vizion historik tejet interesant mbi atë që ndodhte në Europën Lindore dhe në Rusinë aziatike, korrigjuar nga një besim i patundur në evolucionin e nevojshëm progresiv demokratik të regjimit bolshevik, edhe pse do të arrihej në kohë të vonë.

Këtë besim të tij e ilustronte me shembuj nga procesi me të cilën Rusia komuniste kishte ngjallur një tharm rinovues në vendet e Azisë qendrore nën sundimin e saj, që do të thotë nëpërmjet një disiplinë të hekurt, por edhe nëpërmjet një veprimtarie shumë të

vecantë kulturore që, brenda një kohë të shkurtër, i kishte cuar këto vende, deri atëhere të përjashtuara nga qyteterimi modern, në një nivel të lartë administrativ dhe industrial.

Kur e lashë – do shprehesha kështu - Ventotene, e përshëndeta Fundon me shpresën se një ditë do shiheshim sërish, pasi me të mund të debatoja mbi këtë faktor themelor të historisë që është revolucioni rus, pasi gjeja tek Fundo një bashkëbisedues të zhveshur nga qëndrimet mendore fanatike dhe një vëzhgues kritik me “bon sens” persë i perket realitetit kontingjent të një ndodhie që, me gjithë arsyet për të mos e pëlqyer, vlerësonte rëndësinë pozitive historike. Shpresë e kotë, pasi siç mora vesh më vonë Fundua i lirë, pasi ra Mussolini, u kthye të merrte pjesë në mënyrë aktive dhe heroike për çlirimin e vendit të vet nga nazizmi. Kur fitorja po i buzeqeshte komunistet e ftuan të rihynte në parti. Fundo refuzoi ftesën dhe u ekzekutua nga komunistët në burgun ku dergjej.” (Ekstrakt i “Riccardo Bauer, Quello che ho fatto. Trent’anni di lotte e di ricordi”, par Piero Malvezzi et Mario Melino, préface d’Arturo Colombo, éd. Cariplo - Laterza, Milan - Bari, 1987, pages 130 et 131).

Bibliografia

Sandro Pertini, a cura di Vico Faggi, “Sei condanne due evasioni” Mondadori, Milano, 1978

Riccardo Bauer, “Quello che ho fatto. Trent’anni di lotte e di ricordi”, par Piero Malvezzi et Mario Melino, Milan - Bari, 1987

Giorgio Braccialarghe, “Nelle spire di urlavento, il confino di Ventotene”, Club degli autori, Firenze, 1970

Ernesto Rossi, Epistolario, 1943-1967, dal Partito d’Azione al Centro Sinistra, par Mimmo Franzinelli, éd. Laterza, Rome – Bari, janvier 2007

“Intervista con Ernesto Rossi” par Luisa Calogero La Malfa, dans “Quaderni dell’Istituto Romano per la Storia d’Italia dal Fascismo alla Resistenza “, n° 1, Rome, 1969

Altiero Spinelli, Come ho tentato di diventare saggio, éd. Il Mulino, Bologne, 1984 et 1987, Nouvelle édition 1988

SKICAT SATIRIKE TË TIJ EPISTOLARI I LLAZAR FUNDOS ME FAN NOLIN

Prof. as. dr Jonela Spaho
Fakulteteti i Edukimit dhe Filologjisë
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë
Email: jspaho@unkorce.edu.al

Dr. Ilir Shyta
Fakulteteti i Edukimit dhe Filologjisë
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë
Email: ishyta@unkorce.edu.al

Abstrakt

Llazar Fundo e përdori penën e tij të mprehtë për të shprehur mendimet dhe qëndrimet e tij mbi çështje të ndryshme politike, shoqërore dhe kulturore. Në vitin 1923, filloi të publikonte skica satirike në "Gazetën e Korçës". Ai ka qenë i angazhuar me copezat letrare dhe satirike, duke i përdorur për të komentuar fenomene shoqërore dhe politike të kohës. Shkrimet e tij shpesh kanë pasur një qasje kritike dhe ironike ndaj realitetit shqiptar. Ai përdor këtë stil në shkrimet e tij për të denoncuar padrejtësitë, korrupsionin dhe shkeljet e së drejtës në Shqipërinë e asaj kohe. Ky stil e bën lexuesin të reflektojë mbi realitetin, përtej fjalëve të thjeshta. Kjo ndikoi në formimin e një letërsie më të vetëdijshme dhe kritike, ku shkrimtarët e rinj mund të trajtonin tema më të thella dhe universale.

Epistolari apo letërkëmbimi, përbën një nga komponentët më të rëndësishëm të burimeve vetjake të një individi, në rastin konkret të Llazar Fundos dhe Fan Nolit. Fundo ka shkëmbyer letra me intelektualë shqiptarë dhe të huaj, duke përfshirë profesorë, shkrimtarë dhe aktivistë politikë. Korrespondenca e tij shpesh trajtonte çështje kulturore, politike dhe ideologjike, duke reflektuar mendimet dhe shqetësimet e tij. Përmes këtyre letrave, ai diskutonte idetë për reformën arsimore, emancipimin shoqëror dhe përhapjen e kulturës perëndimore në Shqipëri. Korrespondenca e tij ndihmon për të kuptuar mendimin e tij politik dhe kulturor në një kohë kur Shqipëria po kalonte ndryshime të mëdha sociale. Letrat shfaqin aftësinë e tij për të ndikuar dhe bashkëpunuar me intelektualë të tjerë, duke krijuar një rrjet ndikimi që i shtrihej përtej kufijve kombëtarë.

Fjalë kyçe: *Letërkëmbim, skica satirike, Epistolar, realizëm kritik, novatorizëm*

HIS SATIRICAL SKETCHES AND THE EPISTOLARY CORRESPONDENCE OF LLAZAR FUNDO WITH FAN NOLI

Abstract

Llazar Fundo used his sharp pen as a powerful tool to express his thoughts and stances on political, social, and cultural issues of his time. In 1923, he began publishing satirical sketches in “Gazeta e Korçës”, actively engaging with writings that reflected Albanian reality through a critical and ironic lens. His use of satire and critical realism served as a means of denouncing injustice, corruption, and the violation of rights, encouraging readers to reflect beyond the surface of words. This approach contributed to the development of a more conscious and innovative literature, where younger writers could explore deeper and more universal themes.

*A crucial component in understanding Fundo’s intellectual profile is his **epistolary** work—the correspondence he maintained with prominent Albanian and foreign figures, including **Fan Noli**. These letters addressed significant topics such as educational reform, social emancipation, and the spread of Western culture in Albania. Through this exchange, Fundo emerges not only as a writer but also as an engaged thinker, actively participating in intellectual networks that extended beyond national borders.*

*This study highlights the importance of Fundo’s work as an example of **critical realism** and **literary innovation**, as well as the role of epistolary writing in documenting the cultural and political transformations of a pivotal period in Albanian history.*

Keywords: *correspondence, satirical sketches, epistolary, critical realism, innovation*

Llazar Fundo ishte një intelektual idealist, i mprehtë në shkrime, kritizues skrupuloz, njeri i penës dhe i formuar në universitetet më të mirë të kohës që jetoi, aktivist shoqëror e veprimtar i shquar politik, njohës i përkryer i 9 gjuhëve të huaj. I quajtur nga bashkëkohësit dhe miqtë e tij, jashtëkohësi, i kulturuari dhe antikonformisti, politikan vizionar, por edhe publicist i shquar, njeri i formuar me kulturë të gjerë perëndimore, nxënës i liçeut francez në Selanik dhe më pas student i jurisprudencës së Sorbonës, mik i personaliteteve të shquara të kohës si: Heminguejt, A. Barbys, R. Rolan, L. Pirandelo, S. Pertini, A. Anshtajn, Gj. Dimitrov, F. S. Noli, L. Gurakuqi. A. Rustemi etj.,

përveçse në fushën e mendimit dhe të veprimit aktiv, do të linte gjurmët e veta edhe në shtypin e kohës, me shkrimet e tij publiçistike, por edhe me shkrime të karakterit goditës ironiko-satirik, të cilat ai i quan mendime dhe shënime, pjesa më e madhe e tyre e botuar në vitet 1923-24 në “Gazetën e Korçës”. Pseudonimi i tij “Paganus” gjendet i shtrirë në një hark kohor prej më shumë se një dekade dhe do ta hasim shpesh edhe në gazetat: “Liria Kombëtare”, “Koha”, “Bashkimi”, “Dajti”, “Shekulli”, “Republika”, “Shqipëtar i Amerikës”, “Shqipëria e re”, “Gazeta e Korçës”, etj. Llazar Fundo mbetet një nga figurat që integruan gazetarinë, publicistikën dhe letërsinë kritike.

Llazar Fundo, pas diplomimit në Sorbonë, u angazhua ne gazetari dhe letërsi duke u shquar për skicat e tij satirike, që trajtonin çështje të mprehta të shoqërsisë. Ai ishte një shkrimtar dhe gazetar me një stil të mprehtë dhe analitik, që përdorte penën e tij të mprehtë për të shprehur mendimet dhe qëndrimet e tij mbi çështje të ndryshme politike, shoqërore dhe kulturore.

Në vitin 1920, ai u angazhua në gazetari dhe u bë një nga drejtuesit e gazetës “Bashkimi”, e cila ishte një organ i rëndësishëm i lëvizjes komuniste shqiptare. Pas vrasjes së Avni Rustemit, në vitin 1924, ai u bë kryetar i shoqatës “Bashkimi” dhe vazhdoi të drejtonte gazetën me një qasje të re dhe më të thelluar analitike. Në vitin 1930, ai u angazhua në gazetën “Liria Kombëtare”, ku publikoi artikuj dhe kritika që theksonin nevojën për një reformë të thellë shoqërore dhe politike në Shqipëri. Ai, gjithashtu, u mor me përkthime dhe studime të letërsisë dhe filozofisë perëndimore, duke sjellë ide dhe koncepte të reja në diskursin intelektual shqiptar.

Në vitin 1923, kur sapo ishte kthyer nga studimet në Paris, Llazar Fundo filloi të publikonte skica satirike në “Gazetën e Korçës”. Këto shkrime, të mbushura me ironi dhe humor, prekin tema të tilla si: sistemi arsimor, mentaliteti shqiptar, varfëria, gjakmarrja dhe martesat ndërjetare, çështje që ishin ende tabu në atë kohë. Përmes këtyre skicave, ai synonte të nxiste reflektim dhe vetëdijen kritike në shoqëri. Stili i tij u bë i njohur për satirën, humorin inteligjent dhe përdorimin e pseudonimeve. Fundo ka shkruar nën disa pseudonime, njëri prej të cilëve ishte “Paganus”, ndërsa fillimisht ka përdorur edhe pseudonimin “Platonikus”, në shkrimet e tij të hershme. Ai përdorte pseudonimet që

i jepnin liri për të kritikuar shoqërinë dhe institucionet pa frikë nga censura ose reagimet direkte.

Ai ka qënë i angazhuar me copezat letrare dhe satirike, duke i përdorur për të komentuar fenomene shoqërore dhe politike të kohës. Shkrimet e tij shpesh kanë pasur një qasje kritike dhe ironike ndaj realitetit shqiptar. Ai përdor këtë stil në shkrimet e tij shpesh për të denoncuar padrejtësitë, korrupsionin dhe shkeljet e së drejtës në Shqipërinë e asaj kohe. Ky stil e bën lexuesin të reflektojë mbi realitetin, përtej fjalëve të thjeshta. Fundo nuk ishte vetëm satirik; ai bënte reflektime edhe mbi filozofinë dhe kulturën. Përkthimet dhe studimet e tij sjellin ide nga filozofia perëndimore në Shqipëri, duke pasuruar mendimin letrar dhe intelektual. Kjo ndikoi në formimin e një letërsie më të vetëdijshme dhe kritike, ku shkrimtarët e rinj mund të trajtonin tema më të thella dhe universale.

Skicat preknin problematika të shumta të shoqërisë shqiptare si :

- sistemin arsimor, ku ai ironizonte mësuesit, kurrikulën e mangët dhe mangësitë në edukimin e fëmijëve.
- mentalitetin shqiptar dhe zakonet e vjetra; skicat e tij pasqyrojnë përmes humorit sjellje konservatore, paragjykime dhe stereotipe.
- varfërinë dhe padrejtësitë sociale, ku konstatonte kontrastin mes jetës së shtresave të pasura dhe të varfra.
- gjakmarrjen dhe konfliktet ndërfisnore, ku përdorte ironinë për të treguar absurditetin e tyre.

Pa pretenduar të bëjmë një analizë të publicistikës së gjerë dhe të shtrirë në shumë organë të kohës, ku shpaloset qartazi, njeriu i formuar, adhuresi i debatit dhe kritizeri, skrupuloz do të ndalemi te disa skica letrare të botuara te “Gazeta e Korçës”, atje nga fillimi i viteve ‘20, kohë kur ai ishte një djalosh i ri i porsadiplomuar, pa një përvojë të pasur jete, por me një përvojë intelektuale të pasur gjë që vinte jo vetëm nga studimet, leximet dhe njohjet e korifejve të mendimit, por edhe nga aftësia e tij perceptuese, vëzhguese dhe analizuese e realitetit shqiptar në ato vite. Veprimtarinë e tij në shtypin e kohës e filloi pikërisht me këto skica të shkurtra, si kritik i mentalitetit, psikologjisë dhe mënyrës si funksiononte realiteti shqiptar i atyre viteve.

Që prej shpalljes së pavarësisë deri në vitet ‘20, kohë kur ai angazhohet me shkrimet e tij në shtypin e kohës, gjendja në Shqipëri vazhdonte të ishte kaotike. Mentaliteti dhe mënyra e jetesës vazhdonte të ishte pre e

trashëgimisë pesëshekullore orientale. Jeta politike, gjithashtu, i përshtatej pikë për pikë këtij realiteti, vendi nuk po bënte hapa përpara dhe për djaloshin e kthyer nga Franca demokratike, prej të cilës çdo intelektual i shquar ka mbajtur në zemër fjalët: Liri, Barazi, Vllazëri dhe i njohur me idetë më ndriçuese të botës artistike, por edhe të jetës kulturore të kohës, kur është kthyer në Shqipëri ai ka vërejtur se pjesa më e madhe e shoqërisë shqiptare ishte e vjetëruar në ide dhe konvencionalë në bindje. Llazar Fundo duke shprehur qëndrime kritike ndaj realitetit shoqëror të kohës, analizues i hollë dhe kritizues i dukurive të reja, por të kontestuara nga mentaliteti i mykur i kohës, bëhet kështu pararendësi i një lloji shkrimi, që në vitet në '30 do ta praktikojnin dendur plejada e shkrimtarëve të realizmit kritik të ne, që ngritën zërin për një botë të re. Jo konformist për nga natyra e vet, Zai Fundo ka pasur guximin e kritikut të ndërgjegjshëm që të vërë gishtin mbi plagë që shqetësonin shoqërinë shqiptare të kohës. I ri dhe plot entuziazëm, anëtar i shoqërisë “Bashkimi” të themeluar prej Avni Rustemit, që kishte për qëllim tërheqjen e rinisë shqiptare në radhët e saj, por edhe protestën ndaj sistemit të kalbur feudo-çifligar në Shqipëri, ai e ka filluar veprimtarinë e tij publicistike me vendosmërinë për që ta parë të vërtetën në sy dhe t’u qëndruar deri në fund pikëpamjeve të veta, për t’i thotë çdokujt atë që i takon dhe për t’i vënë çdo gjëje emrin e vërtetë. Ai ka tentuar që t’i çjerrë maskat shoqërisë duke nxjerrë në pah hipokrizinë, konformizmin, korrupsionin dhe deformimet e tjera në mentalitetin e saj. Duke u shfaqur në këto shkrime si hibrid i gazetarit dhe krijuesit letrar, por edhe i filozofit të hollë, të gjitha skicat dhe esetë e tij të krijojnë përshtypjen e një pasqyre a të një kronike të aspekteve të ndryshme të jetës së asaj kohe. Dukuritë dhe fenomenet që meritonin të trajtoheshin atëhere ishin shumë, në Shqipërinë e varfër dhe të prapambetur, të shfrytëzuara prej një grupi jo aq të vogël feudalësh dhe pushtetarësh. Qënia dhe integriteti i njeriut nuk kishin qenë aq të cënuara sa në atë kohë.

Periudha midis dy luftërave botërore jo vetëm te ne, por në mbarë botën shënohet në historinë e kulturës së përbotshme si një kohë e shfaqjes së pesimizmit më të hidhur dhe më të rëndë edhe në letërsinë dhe filozofinë e perëndimit. Ekzistencializmi, si filozofi e dëshpërimit dhe e ardhmërisë, në të cilën dyshohej, ka lulëzuar sidomos në këtë periudhë të vështirë të kontinentit të vjetër si manifestim i gjendjes shpirtërore të njerëzimit. Duke lexuar shkrimet e Zai Fundos të asaj

periudhe mund të shohësh se ai e ka perceptuar shumë qartë situatën dhe krizat ekzistenciale jo vetëm të njeriut, por të gjithë shoqërisë. Problemet që prek ai në këto shënime kanë të bëjnë, përgjithësisht, me emancipimin e shoqërisë shqiptare, duke kapur aspektin e edukimit të brezit të ri, luftën kundër normave dhe zakoneve kanunore të rrënjësura ne ndërgjegjen kolektive, gjakmarrjen si një plagë që duhej zhdukur, mbetur trashëgimi nga obskurantizmi i mesjetës, gjendja e arsimit, ushtrisë, ekonomia e rënuar shqiptare, etj.

Te disa skica vihet re prirja e përherëshme filozofuese edhe pse problemet që shtron në skicat e tij ai i jep në aspektin satirik dhe fshikullues, por nuk është e vështirë të shohësh harmonizimin e satirikut me filozofin në një simbiozë të shkëlqyer. Te shënimi “Edukimi i popullit” ai kap një aspekt shumë të rëndësishëm atë të edukimit të brezit të ri. Një nga temat që ndihet pothuaj në pjesën më të madhe të shënimeve të tij është mentaliteti barbar i njeriut, por edhe i popullit në përgjithësi. Në këtë kontekst, te ky shkrim ai ka kapur modelin se si ky barbarizam përcillet tek brezi i ri dhe mjeti që përcjell atë në mënyrën më paradoksale është kënga, e cila kap rrënjët prej ku merr shkak e pandërgjegjshmja kolektive për të shprehur instiktet e trashëguara shekullore. I ndërtuar përmes kontrastit, ky shkrim përmban një mesazh të fuqishëm; zhvendosjen e mentalitetit dhe kulturës nga barbarizmi drejt emancipimit.

“Njerëzit u gëzuan që gjykata dënoi vllavrasësin dhe për të festuar këtë gëzim shkojnë në kafene dhe ja marrin këngëve që në qendër kanë vrasjet pusitë dhe koburet. Djemtë e vegjël që i dëgjojnë këto këngë si filiza të njomë, që janë i adoptojnë direkt, i thithin si qumshti e mezi presin të bëhen heronjtë dhe përdoruesit të ardhshëm të këtyre bëmave.”¹ Me ironinë karakteristike te tij Pagani thotë: “Çuditërisht nuk i ka rënë në mënt Arsimit t’i mbledhë këto këngë dhe t’ua mësojë djemve në shkollë që të pasurohet literatura dhe drejtësisë mos i vinte ligisht.”² Me një guxim qytetar dhe me penën e tij fshikulluese ai jep mesazhin e qartë: Duhet të bëhen zhndrrime të brendshme në nënvetëdijen kolektive, pikërisht atje ku preken rrënjët e identitetit dhe kulturës.

Në shkrimin “Qytetërimi” ai vë përballë qytetërimin evropian dhe barbarinë e afrikanëve; të parët e zhvillojnë luftën me mjete moderne,

¹ Gazeta e Korçës, 1923, Nr.6, f.2

² Po aty.

ndërsa të dytët, të paqytetëruarit e bëjnë me shkopinj, “në fund të fundit kaçafytje mbetet..”. Satirisa më e madhe drejtohet drejt përfaqësuesve të fesë të cilët i bekojnë lufrat. Në fund ai e mbyll me frazën: “Le të lemë më njënë pra luftën dhe; roftë qytetërimi!”³, që përcjell mesazhin se zhvillimi dhe qytetërimi i ndërtuar me kaq mundim ka nevojë për paqe dhe mirëkuptim, pasi lufta e shkatërron atë që njeriu ka ndërtuar me aq mund, skicë kjo që të kujton “Të korrurat “e Migjenit ku nëpërmjet antitezës ai jep diversitetin e natyrës njerëzore që shkatërron me duart e veta atë që e ka krijuar me aq mund ndër shekuj.

Në shkrimin “Të tërbuarit” autori fut mizorinë njerëzore duke e ballafaquar me tërbimin e një qeni, Njerëzit ndjekin për të vrarë kafshën me preteksin se është e tërbuar dhe kur qeni jep shpirt zhvillohet skena me brutale njerëzore, ku njerëzit kënaqen nga vuajtja e qenit dhe dëfrehen me kafshën që po jep shpirt. Me nota të forta sarkazme ai godet duke thënë: “Të këtilla sqena populli duhet të ketë rastin t’i shikojë dendur që të edukohet dhe do t’i ketë se edhe qeveria edhe bashkia e Korçës i kanë merak vetë t’i edukojnë”⁴.

Duke goditur zakonet e hakmarrjes që transmetohet dhe në brezat e rinj, autori te shkrimi “Pamje madhështore”, trajton rastin e një djaloshi 17- vjeçar që qëllon vrasësin e të atit. Shtypi i kohës e lartëson këtë akt si akt sublim të fisit të bekuar të shqiptarit, akt me të cilin duhet të mburremi dhe Fundo me satirën e tij fshikulluese i këshillon gazetarët ta marrin shtruar se me këtë soj artikujsh marrin njerëzit urrejtje dhe derdhen shumë gjak, viktimë e të cilit mund të bëhet dhe artikullshkruesi.

Zai Fundo i ka përcjellë me reagim humoristik dhe satirik dukuritë më karakteristike të kohës dhe këtu qëndron vlera më e madhe dokumentare, shpirtërore dhe artistike e shkrimeve të tij të kësaj kohe. Me humor, ironi e satirë, ai është përpjekur të shkruajë qartë dhe të tërheqë vëmendjen e lexuesit. Prej francezëve ai ka mësuar të shkruajë sikur bisedon me ndonjë të njohurin e vet. Ai nuk krijon humor banal dhe nuk grish kureshtjen e lexuesve në mënyrë artificiale. Humori i tij satirik që nuk i reshtet përqeshjes ndonjëherë ia çel lexuesit horizontet për të parë se çfarë fshihet pas maskave. Ata që do t’i lexojnë këto shkrime do shohin brenda tyre aktualitetin dhe do të ngushëllohen me mendimin se bota e tillë ka qënë gjithmonë. Në shkrimin “Jeta e

³ Gazeta e Korçës, 1923 Nr.3 f.2

⁴ Gazeta e Korçës, 1923, Nr.5, f.3

Debojës” ai ironizon kushtet e vështira dhe të papërshtatshme të të rinjve që shkojnë ushtarë. Duke përdorur parimin e të kundërtave, karakteristikë e stilit të tij, ai nga njëra anë lartëson përgjegjshmërinë e misionit të ushtarit dhe nga ana tjetër me ironi thërëse i këshillon ata të marrin lejën dhe të rinë 6 muaj në shtëpi, që të shpëtojnë të paktën shëndetin e tyre, duke aluduar për korrupsionin në radhët e ushtrisë dhe mungesat që konstatohen atje.”Tani n’është nonjë ushtar grindavec e jo dorë hollëqë mërzhitet nga ushtria, I këshillojmë të bëjë sit ë bëjë dhe të çkëputet një gjashtq muaj ose një mot me leje...për shkak shëndeti I S’është gjë që s’bëhet!”⁵, e mbyll ai me sarkazmë therëse, duke kritikuar dhe prekur një problem shumë të rëndësishëm për ardhmërinë e shtetit të brishtë shqiptar.

Në shkrimin që merr shkas nga akti i guximshëm i dy të rinjve që arritën të ngrihen mbi mentalitetin dhe të rrëmbehen sepse prindërit dhe shoqëria nuk i lejojnë martesat midis feve, autori duke satirizuar thotë: Sikur të kishin vjedhur ose të kishin vrarë faji do t’ish më i vogël se krimi që kanë bërë.”⁶ Duke u tallur thotë se nëse të gjithë përzihen kështu nga kjo do të vjë fundi i botës.

Te “Spiritizma”⁷ ai kapet me një argument sa religjioz aq edhe filozofik duke qesëndisur të gjithë ata që kërkojnë prova konkrete për ekzistencën e zotit; ”Perëndinë e ke përpara syve thosh një theollog, mbeso dhe do ta shohësh”, duke u nisur nga filozofia e Kantit se zoti nuk është çështje botëkuptimi por besimi.

Këto janë proza të startit të shkurtër, ndoshta duke qenë një prirje spontane që vinte nga impulsi i reagimit ndaj dukurive që e shqetësonin. Këto proza, megjithëse nuk iu mungon fuqia kreative përgjithësisht ngrihen mbi faktin e regjistruar, por mendimi figuron pak i shkëputur. Në to vetëm sa shprehen me një gjuhë korrekte dhe të permbledhur vrojtimit e një shikuesi, duke treguar se fuqia e fjalës është mjeti i luftës së përditëshme për transformimet më urgjente shoqërore. Shkrimet e tij ndonëse të vogla kanë rëndësinë e tyre historike kulturore sepse pararendin një horizont të ri krijues, çka do të konkretizohet më tej në letërsinë e viteve ‘30 me skicat letrare të Nonda Bulkës dhe shkrimtarëve të tjerë të kësaj periudhe. Fundo ka një sy të mprehtë vëzhgues dhe mjeshtëri për të dhënë, në fare pak vija,

⁵ Gazeta e Korçës, 1923, Nr.9, f.2

⁶ Gazeta e Korçës, 1923, Nr.4, f.2

⁷ Gazeta e Korçës, 1923, Nr.1, f.3

personazhe dhe mjedise karakteristike. Zakonisht, shkrimet e tij janë ndërtuar me një stil shumë konçiz dhe energjik, që e kërkon edhe përmasa dhe lloji i tyre.

Zai Fundo shquhet për një satirë e hollë dhe ironi të mprehtë: Ai përdor humorin për të nxitur reflektim të ndërgjegjeshëm te lexuesi. Skicat nuk janë vetëm argëtuese, por ofrojnë një kritikë të thellë ndaj padrejtësive dhe mangësive të kohës. Ka një qasje universal në shkrimet e tij me temat sociale, në një mënyrë që lexuesi i sotëm mund t'i kuptojë dhe të lidhet me to.

Ka tek ai një ndikim nga publicistika satirike bashkëkohëse franceze, por edhe nga satiristë klasikë francezë, duke nisur nga Volteri, të cilit, ndonjëherë i huan edhe argumente. Në shkrimet e “Paganit” në vitet ‘20, është karakteristik mohimi. Ky nuk pasohet nga pohimi për të ardhmen. Për më shumë, në krijime të ndryshme, tingëllon një notë pesimiste, që shpjegohet me pamundësinë e ndryshimit të situatës, e cila kërkon kohë dhe siç thotë Konica jo shndërrime të imponuara, por që vijnë nga brenda. Sidoqoftë shkrimet e tij satirike sollën një frymë emancipuese, spontane dhe të drejtpërdrejtë, si një erë e re që do të fryntë në mentalitetin shqiptar që priste ndryshime të thella dhe rrënjësore. Llazar Fundo mbetet një nga figurat që integruan gazetarinë, publicistikën dhe letërsinë kritike.

Stili i tij i satirës inteligjente dhe i analizës shoqërore është një pikë referimi për shkrimtarët shqipëtarë që vijuan traditën kritike dhe intelektuale. Në thelb, Fundo ndikoi në letërsinë shoqërore shqiptare duke krijuar një hapësirë për kritikë, reflektim dhe angazhim shoqëror, duke e bërë letërsinë jo vetëm një mjet artistik, por edhe një vegël për ndërgjegjësim dhe ndryshim shoqëror.

Epistolari i Llazar Fundos me Fan Nolin

Letrat tregojnë rrugëtimin intelektual të Fundos, që nga fillimet e tij si student në Paris, tek angazhimi i tij në gazetari dhe skicat satirike, deri tek aktiviteti politik dhe antifashist. Korrespondenca e tij ndihmon për të kuptuar mendimin e tij politik dhe kulturor, në një kohë kur Shqipëria po kalonte ndryshime të mëdha sociale. Letrat shfaqin aftësinë e tij për të ndikuar dhe bashkëpunuar me intelektualë të tjerë, duke krijuar një rrjet ndikimi që i shtrihej përtej kufijve kombëtarë. Epistolari apo letërkëmbimi, përbën një nga komponentët më të rëndësishëm të burimeve vetjake të një individi, në rastin konkret të Llazar Fundos dhe

Fan Nolit. Epistolari paraqitet i pranishëm në dis momente të jetës, si pjesë e pandarë e veprimtarisë së tyre politike dhe jo vetëm. Fundo ka shkëmbyer letra me intelektualë shqiptarë dhe të huaj, duke përfshirë profesorë, shkrimtarë dhe aktivistë politikë. Korrespondenca e tij shpesh trajtonte çështje kulturore, politike dhe ideologjike, duke reflektuar mendimet dhe shqetësimet e tij. Përmes këtyre letrave, ai diskutonte idetë për reformën arsimore, emancipimin shoqëror dhe përhapjen e kulturës perëndimore në Shqipëri. Fundo përdorte letrat për të kritikuar situata të padrejta dhe për të sugjeruar përmirësime. Shkrimet e tij ishin të drejtpërdrejta, por elegante, duke mbajtur stilin intelektual dhe satirik që e karakterizonte edhe në gazetari dhe skicat letrare. Ai diskutonte shpesh edhe çështje filozofike.

Një pjesë e letrave të tij ruhen në arkivat historike dhe koleksione private, dhe ato janë burim i rëndësishëm për studiuesit e historisë së letërsisë dhe politikës shqiptare. Korrespondenca e tij ndihmon për të kuptuar mendimin e tij politik dhe kulturor në një kohë kur Shqipëria po kalonte ndryshime të mëdha sociale. Letrat shfaqin aftësinë e tij për të ndikuar dhe bashkëpunuar me intelektualë të tjerë, duke krijuar një rrjet ndikimi që i shtrihej përtej kufijve kombëtarë.

Në disa letra të dimrit të vitit 1933, (saktësisht të datave 11⁸, 16 dhe 26 janar) mes tyre, mes pyetje-përgjigjesh, del në pah ecuria e botimit të gazetës “Liria Kombëtare”⁹ dhe gjendja e Shqipërisë dhe botës së atij viti, por edhe zhvillimeve kryesisht në Amerikën e largët.

⁸ Nasho Jorgaqi. *Letërkëmbimi i Fan Nolit*, Shtëpia Botuese Erik, Tiranë, 2012, f. 304-305;

⁹ Gazetë e përdyjavshme, organ i organizatës demokratike shqiptare në mërgim «Komiteti i Çlirimit Nacional» (KÇN). Numri i parë doli më 29.7.1925 në Gjenevë (Zvicër) dhe vijoi me ndërprerje deri më 1935. E drejtonte patrioti demokrat Omer Nishani. U bë tribunë e emigracionit revolucionar në luftën kundër regjimit zogist, dhe fashizmit. Gazeta pasqyroi me hollësi gjendjen e popullit shqiptar, demaskoi ashpër shtypjen ekonomike shoqërore e politike të vendit dhe politikën skllavëruese të Italisë fashiste, analizoi në frymë patriotike qëndresën e fshatarësisë e të klasës punëtore për vendosjen e një rendi demokratik të përparuar. L. K. parashikoi se politika grabitqare e pushtesit italian në Shqipëri ishte liapi i parë drejt agresionit të armatosur kundër popullit shqiptar. Shpëtimin e popullit shqiptar L. K. e shihte në fitoren e revolucionit popullor të udhëhequr nga Partia Komuniste, themelimin e së cilës ajo e konsideronte një detyrë imediate. L. K. kultivoi edhe frymën e internacionalizmit proletar. Ajo gëzonte simpati e popullaritet në emigracionin demokratik shqiptar, si dhe në lëvizjen revolucionare në Shqipëri.

Kjo tablo prek në letërkëmbim, kombin dhe vetë globin. Luftrat dhe kriza financiare, lëvizja patriotike atdhetare, Ahmet Zogu, internimet, arrestimet, rrethet e nacionalistëve dhe agallarëve, rebelimet e punëtorëve, demonstratat, era e barutit që vjen nga të katër anët e globit, rekrutimet e reja në grupimet e para komuniste, dobësimet e organizimit në vend apo veçanërisht zhvillimet në Rumani dhe Jugosllavi, aleatët, të gjithë pa përjashtim bëhen pjesë e këtij epistolari. *“Nga të katër anët vjen erë baruti. “Bota mizore” e ka pisk. Edhe ju atje s’e keni shumë mirë. Kini një 15 milionë të papunë. Ishallah do të bëhen edhe më shumë. Se po s’u turbullua s’kullohet, thotë fjala. Ose ...haberet që më dërgoni nga Amerika na vijnë fare të hidhura. Andej e fitoj luftën Sulltani. Pllanet t’uaja s’dualle”*¹⁰.

Ndërkaq, në letërkëmbim, Fundo i raporton Nolit për gjendjen e brendshme të vendit. *“Puna brënda ecën ngadalë, po ecën. Kemi hedhur themele mjaft të gjëra. Kemi rekrutuar ca shokë të mirë. Jemi qint për qint më mirë nga ç’kemi qenë dy vjet më parë. Po natyrisht jemi shumë të dobët. Halimi ka qenë brenda ca kohë. Tani i internuan njerëzit nga inati. Gjendja brënda është ashtu si e dimë dhe shumë më keq. Regjimi e di se diç bëhet brenda dhe ka vënë gjithë fuqitë për të gjetur gjurmët. Gjene shyqyr që s’më arrestuan. Këtu punët po majisen. Morali në punëtori është i mirë”*¹¹.

Pjesë e epistolarit janë edhe emrat Halim Xhelos, Omer Nishanit, filantropit Kristq Turtulli, Riza Cerovës dhe Lano Borshit, për të cilët autori kur i përmend hedh një tis të hollë satirik, por edhe miqësor. Tek letra e 11 janarit 1933 mësojmë se *shëndeti i Turtullit nuk është i mirë, pasi kohët e fundit ka qenë i sëmurë. Halimi është duke shkuar në (q)be dhe se Lanua s’lë gazetë pa kënduar. Po jo artikuj...*¹²

Përmes epistolarit mësohet ecuria e organit gazetaresk “Liria Kombëtare”, që në letra shkruhet shkurt, me initiale L. K. nga Llazar Fundo. Ndërkohë, pyetet Noli edhe për ecurinë e gazetës “Dielli”¹³ në Amerikë. Mësojmë nga ky letërkëmbim se në disa numra të gazetës “Liria Kombëtare” është botuar korespondenca e zgjedhjeve nga Shqipëria. *“Do t’a keni kënduar korespondencën që vjen nga Shqipëria*

¹⁰ Nasho Jorgaqi. *Letërkëmbimi i Fan Nolit*, Shtëpia Botuese Erik, Tiranë, 2012, f. 305;

¹¹ Po aty;

¹² Po aty;

¹³ Gazeta *Dielli*, organ zyrtar i Vatrës, nisi botimin në SHBA më 15 Shkurt 1909;

*që u botua në L.K. për punë të zgjedhjeve. Është, natyrisht, korespondencë autentike prej një shoku shumë serioz*¹⁴.

Po Dielli del, apo jo? -pyet Nolin, Llazar Fundo. Më pas i lë porosi Nolit që të përhapë në Amerikë gazetën “Liria Kombëtare”. Duket merakë i një patrioti që i bën gjërat me mish e me shpirt për Shqipërinë. Fundo i shkruan: “*Shikoni na gjeni ca shokë andej, të cilët të merren më përhapjen e L. K. Kujdesu një çikë për këtë punë. Tani që Republika vdiq, të përhapet të paktën L. K. Në numrin që vjen do t’i biem atij Faik Maskarajt. Mesa duket problemet mes Nolit dhe miqve të tij, kishin lindur me Faik Konicën. Ndoshta për ndonjë inat të ri mes të treve, përderi sa Zai shpreh qaq inat për Konicën në këtë letër...*”¹⁵

Ajo që është sërish e rëndësishme nga ky letërkmbim është fakti se përmes tij hidhet dritë rreth punës përgatitore që po bën Noli për të botuar librin e tij të vetëm me poezi të titulluar “Album”. Noli mesa duket e ka në planet e tij botimin dhe ka nisur të përmbledhë vjershat që i ka botuar në ato pak gazeta të kohës së tij në Shqipëri dhe jo vetëm. Në këtë letër Llazar Fundo i kthen përgjigje Nolit për poezitë që kërkon t’ia gjejë numra të ndryshëm të L. K. Gazeta botohej në Gjenevë dhe ato numra që Noli ia kërkon, nuk i ka as Zai Fundo në Korçë. Ndërkohë me humor e pyet Nolin: “*Juve, duket ju vete mbarë tregëti, që dashki tani të nxirni edhe një libër me vjersha. Apo bëni tregëti vetëm e vetëm për të bërë tregëti?*”¹⁶

Ndërkaq, kujtoj se ky libër do të botohet vetëm në vitin 1948 nën kujdesin e Mitrush Kutelit dhe do të majë titullin “Album”. Dhimitër Pasko mesa duket ka bërë atë punë që vetë fan Noli s’e bëri, pasi nën kujdesin e tij vjershat u mbledhë dhe u botuan, sikurse bëri edhe me poezitë e Lasgush Poradecit.

Letrat hapen dhe mbyllen me politesë të përkorë nga Lazar Fundo, kjo si rrjedhojë edhe e kulturës së tij marrë nga shkollimi dhe qëndrimi në shtete të ndryshme. Letrat drejtuar Nolit nisin: *I dashur Imzot dhe përfundojnë: Juaji me mall Llazar Fundo*¹⁷.

¹⁴Nasho Jorgaqi. *Letërkëmbimi i Fan Nolit*, Shtëpia Botuese Erik, Tiranë, 2012, f. 305;

¹⁵Po aty;

¹⁶Po aty;

¹⁷Nasho Jorgaqi. *Letërkëmbimi i Fan Nolit*, Shtëpia Botuese Erik, Tiranë, 2012, f. 305;

Bibliografi

Nasho Jorgaqi. *Letërkëmbimi i Fan Nolit*, Shtëpia Botuese Erik, Tiranë, 2012, 610 f.

Gazeta *Liria Kombëtare*, Gazetë e përdyjavshme, Numri i parë doli më 29.7.1925 në Gjenevë (Zvicër)

Gazeta *Dielli*, organ zyrtar i Vatrës, nisi botimin në SHBA më 15 Shkurt 1909;

Gazeta e Korçës, 1923, Nr.1, 2, 3, 4, 5, 7, 9.